

VETERANI

GAZETË PERIODIKE NR. 3 (327) Mars 2016 ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: WWW.VETERANIOBVL.ORG

PËRVJETORI

Komandanti legjendar Adem Jashari e shndërroi Prekazin në Krujë të dytë

FAQE 3



HISTORIA

72-vjetori - Brigada e VII-të S, një nga brigadat më të shquara të Ushtrisë Nacionalçlirimtare

FAQE 2



DOSSIER

Shkolla "Skënderbej", trup pedagogjik cilësor dhe studentë të përkushtuar

Ing. Myfit GUXHOLLI

FAQE 4



65 vjet më parë – Si u ekzekutuan pa gjyq 22 intelektualë

Nga Halil RAMA

Gjashtëdhjetëepesë vjet më parë, më 19 shkurt 1951, në orën 17 e 47 minuta u hodh në oborin e ndërtesës së Ambasadës Sovjetike një sasi e vogël dinamiti me potencial të reduktuar. Një krisje e fortë dhe disa xhama të thyer. Asgjë më shumë. Alarm në Ministrinë e Brendshme dhe në qarqet e larta politike të Tiranës. Shqetësimin në Ambasadën Sovjetike të Tiranës dhe në Ministrinë e Jashtme të BS.

Plenumi i KQ të PPSH i ndërpreu përkohësisht punimet në paraditen e datës 20.02.1951, sepse u mblodh urgjentisht Byroja Politike e KQ të PPSH, që mori në shqyrtim incidentin e rëndë në Ambasadën Sovjetike.

Në seancën e datës 20 shkurt 1951, Byroja Politike e KQ të PPSH dëgjoi raportimin e ministrit të Brendshëm, Mehmet Shehu. Ai e cilësoi këtë ngjarje, "Një politikë të kalibrit të madh, madje më e madhe se një atentat që mund të bëhej kundër ndonjërit nga ne".

Pas të ashtuquajturës "bombë në Ambasadën Sovjetike", klika kriminale në krye të PPSH e qeverisë komuniste urdhëroi marrjen e masave të jashtëzakonshme represive "pa marrë parasysh ligjet në fuqi"! Mehmet Shehu që urdhëroi një represion të tillë të parë do të shprehej se, "Një masë të tillë ne e kemi marrë edhe kur u vra Bardhok Biba, dmth kemi pushkatuar edhe jashtë ligjeve në fuqi". Ministri i Brendshëm kërkoi nga Byroja Politike që arrestimet të bëheshin qysh atë natë, pa bërë hetime për ngjarjen dhe pa gjetur provat për personat e pandehur.

FAQE 6

Kuvendi vendosi komandant të përgjithshëm Skënderbeun, duke njohur autoritetin e tij politik dhe ushtarak

"Besëlidhja e Lezhës", Kuvendi ku u hodhën themelet e bashkimit kombëtar



Besëlidhja e Lezhës përbën një prej ngjarjeve më të rëndësishme të historisë së mesjetës. Më pas, ky bashkim i popullit shqiptar do të përsëritej, kur në vitin 1878 do të mbahej Lidhja e Prizrenit, e më pas në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare, Konferenca e Pezës. Në të gjitha këto lidhje ideja themelore ishte bashkimi pa dallim feje, krahine dhe pikëpamje politike i shqiptarëve për çështjen kombëtare

Faqe 5

URIMI

OBVL uron veteranët e LANÇ të Kosovës në 8-vjetorin e pavarësisë



FAQE 3

IN MEMORIAM

Tetë vjet pa Ramadan Sokolin, studiuesin që shqipëroi shekujt



Nga Ilir Seci

FAQE 9

PROFIL

DR. NOVRUZ ZEJNATI - KOLONELI QE SHKRUAN PER TE GJITHE



Nga SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 12

PROFIL

LAMTUMIRE MIFTAR NDREU!!!



FAQE 8

KULTURE

Një roman i gjeneralit për gjeneralin



Nga NOVRUZ ZEJNATI

FAQE 12

Në fillim të shek. XVIII-të, Kallmeti u shpall bajrak më vete, u shkëput prej Zadrimesë, por mbeti me lidhje të ngushta tradicionale

Zadrimea (Tejdrina) e vetëqeverisur përmë se dy shekuj

Nga Xhemal MEÇI*

FAQE 10



PËRVJETORI

Në faqet e historisë së Brigadës së VII-të Sulmuese radhiten shumë partizanë e kuadro që ranë në ballë të luftës 72-vjetori - Brigada e VII-të S, një nga brigadat më të shquara të Ushtrisë Nacionalçlirimtare

Brigada e VII-të Sulmuese u formua më 17 mars 1944 në Vlushë të Skraparit. Komandanti ushtarak ishte Gjin Marku, ndërsa komisarët politikë ishin Kadri Hoxha dhe Adil Çarçani. Dy muaj më parë këtu në Vlushë nazistët gjermanë vranë 114 skraparllinj, duke përfshirë edhe ata të fshatrave Krushovë, Kapinovë e Turbehovë.


Me të marrë urdhërin, Gjin Marku iu vu punës organizuese të kësaj Brigade. Në shtëpinë e Kahreman Yllit, në prani të Myqerem Fugës u bë organizimi i Brigadës. Batalioni i Parë u formua kryesisht me partizanë të Qarkut të Beratit me një kompani nga Devollit, Batalioni i Dytë kryesisht me partizanë të grupit të Skraparit, ndërsa Batalioni i Tretë u formua nga partizanë të Qarkut të Gjirokastrës, me në krye Gani Nivicën (dëshmor), me një kompani nga Batalioni i Dëshnicës.

Në garnizonin e Beratit e kryesisht në Kuçovë kishte pak gjermanë, kryesisht kishte forca të Ballit Kombëtar dhe të Gjindarmërisë. Mbrojtja ishte organizuar kryesisht me pikëmbështetje të forta. Mund të përmendim Kalanë, Shëndëllinë, Lisin e Beçit dhe vetë kazemat ushtarake. Kuçova, vetë fusha e Otlakut dhe Ura Vajgurore kishin të tjerë garnizone mbrojtje.

Këto objekte, të lidhura me copa transhe dhe hendeklidhje përbënin një mbrojtje të fuqishme, me të cilat do të përballje Brigada e VII-të. Sekretit i armikut qëndronte në shumëlojshmëri dhe pozicioneve të zjarrit. Disa nga këto ishin të pushtuara dhe disa jo. Tanket nuk qëndronin në qytet. Ato afroheshin pranë kazermave vetëm kur partizanët e Brigadës së VII-të e rrezikonin qytetin.

Pas urdhërit të Komandantit vinin urdhëra të tjerë, të nënshkruara nga Spiro Moisiu për çlirimin e Beratit, për përballimin e Operacionit të qershorit, për çlirimin e Kuçovës etj. Për çlirimin e Beratit dhanë ndihmesën e tyre vetë beratasit. Qysh në goditjen e parë mbi harkun e parë mbrojtës ra partizani Thoma Shqina, një nga të rinjtë e zjarrit të këtij qyteti. Po atë ditë ra Rahmi Stropani nga treva atdhetare e Devollit. Nuk mund të numërohen aktet heroike të partizanëve nga Zona e Skraparit dhe e Dëshnicës.

Në faqet e historisë së Brigadës së VII-të Sulmuese radhiten shumë partizanë



e kuadro që ranë në ballë të luftës. Po përmendim disa nga kuadrot drejtuese politikë: Koli Myzeqarin, Skënder Libohova, komandant batalioni, Haxhi Dokon, Fahri Zaimin, Mehdi Vilën, Loni Odriçanin, Thimi Tanin, Naim Gurin, komisar kompanie.

Në kujtimet e tij, Myqerem Fuga kujton: "Ngritën këshillat apo u rizgjedhën këshillat nacionalçlirimtarë në zonën e nahijes së Beratit, në Sulovë, në zonën e Shpriagut, në zonën e Tërpanit dhe deri në zonat e thella të Roskovecit, të Myzeqesë e të Dumresë".

Përkrah Brigadës së VII-të vepronte edhe Grupi i Skraparit. Veprimet luftarake i kordinonte Komandanti i Brigadës, Gjin Marku me Komandantin e Grupit të Skraparit, Njazi Çepanin. Një punë të mirë kuadrot e kësaj Brigade bënë edhe me organizatën e rinisë. Batalioni i dytë u kthye nëpër fshatrat e Komunës së Potomit dhe asaj të Çepanit, ku me dhjetra partizanë të rinj shtuan radhët e Brigadës. Goditjet e njëpasnjëshme të batalioneve të Brigadës kanë qenë të furishme të cilat arritën deri në Mollas të Sulovës, kurse nga krahu i majtë deri në afërsi të Fierit. Nuk mund të lëmë pa përmendur punën e shoqës Shpresa Hoxha (Fuga) në Skrapar, në Berat e deri në Fier e Dumre. Në punën organizuese në Qarkun e Beratit u dalluan mjaft kuadro, sa është e vështirë t'i rradsimis të gjithë. Veprimet luftarake të Brigadës në përballimin e Operacionit të qershorit qenë të tilla që i detyruan qysh në fillim forcat gjermane të tërhiqeshin në Berat. Meqenëse disfata e këtyre forcave deformonte planet për të dalë në bregdetin shqiptar, filloi përsëri sulmi drejt Paraspuarit e Qafë-Shkozës

dhe takimi i këtyre forcave do të bëhej në Kreshtat jugore të Beratit. Tre kuadrot kryesore Gjini, Kadriu dhe Neshati ishin në Kongres të Përmetit. Iu deshën Adil Çarçanit, Ramiz Alisë dhe Njazi Demit t'i viheshin kundërveprimit të forcave armike-tregon Myqerem Fuga.

BETEJAT HEROIKE KUNDËR GJERMANËVE

Në Arkivin Qëndror të Ushtrisë është një copë radiogram që udhëzonte forcat partizane në rast shpartallimi, të përqëndrohen tek stanet e Sinan Leshnjës në Turbohovë dhe të shtëpitë e Feim Gërmenjit, tek mullinjët, me parrullën dhe kundërparrullën "Lufta-Liria".

Po ku i dinin këto vende kaq të fshehta? Kjo ndodhte sepse vetë komandanti i kishte shkelur me kohë këto vende. Jo pa qëllim e dërgonin atë radiogram Myqerem Fuga dhe Aqif Ylli që komandonte detashmentin e ruajtjes së Shtabit. Por ajo që ngjalli habinë e partizanëve të Brigadës dhe të të gjithë ushtrisë partizane që forcat e kësaj Brigade kryen natën atë manovër të guximshme, do të mbetet historike. Ndërsa gjermanët u hodhën përtej Osunit e Çorovodës, forcat e Brigadës kaluan në marenë e Kakrukës, në anën tjetër të Osunit, por kjo kërkonte guxim, fshehtësi e disiplinë.

Këta ishin partizanët trima të Brigadës së VII-të Sulmuese. Më 10 qershor u grumbulluan tek Stanet e Babait, rrëzë malit Tomorr. Pas analizës kaluan në loja të bukura dhe festuan fitoren për çlirimin e Beratit. Ditën e fundit u vra partizani Thoma Arbëri. Para se të niseheshin për në Veri të Shqipërisë u grumbulluan në Mollas të

Sulovës.

Na u shtua efektivi me 150 partizanë të rinj nga qyteti i çliruar i Beratit. Kush ndihmoi më tepër për organizimin e tyre? Të gjithë kuadrot, beratas por veçanërisht Myqerem Fuga e Luan Qafëzezi. Marshimi i gjatë në lodhi, por më 19 tetor 1944 u ndodhëm përpara Shënpalit e Gëziqit të Mirditës dhe përpara urës së Fanit. Ajo që tërhoqi vëmendjen e partizanëve dhe të popullit të këtyre anëve ishte kalimi në befasi i batalionit të II-të dhe të Batalionit të IV-të me në krye Komandantin e Brigadës para se të sulmohej Shënpali dhe kjo që një veçori e lavdishme. Pasi u morr Shënpali filloi ajo luftë që do të mbahet në histori. Gjermanët u munduan me çdo kusht që ta mbanin të hapur këtë rrugë, kurse partizanët kurrësi nuk i lejonin.

Në krah të Brigadës së VII-të arriti Brigada e VI-të dhe në krah të majtë Brigada e XXII-të. Për 6 ditë e netë jehoi ajo luftë e paparë ku dhanë jetën 35 partizanë dhe u plagosën 40 të tjerë. Do të ndalem pak në veprimet e Batalionit të III-të. Pasi pushtoi Rubikun, u qep lart në malin e Melungut, tek sheshi i Shpardhës; rrethoi dhe shtiu në dorë këtë bazë të rëndësishme. Lufta vazhdoi nga ura e Matit deri në Shëngjin, ku ngeli si lapidar partizani Bektash Guri. Me këto luftime që zhvilloi kryesisht Batalioni i III-të thuhet se u vranë 100 gjermanë dhe u dëmtuan 40 automjete, por çfarë thonë dokumentet e vetë gjermanëve? Divizioni i ushtrisë gjermane për këtë rajon vërteton se u vranë 111 gjermanë dhe u dogjën 12 automjete.

Kjo është përgjigja për ata që kanë tendencë të nënflutësojnë luftën partizane.

Për shkak të kufizimit të materialit nuk mund të vëmë emrat e atyre që u vranë në këtë luftë, por do të përmendim çlirimin e Shkodrës më 29 nëntor 1944. Në ditarin gjerman kjo jepet qartë në një tekst me rënien e Kotorit!

LUFTIMET NË MAL TË ZI

Nuk mund të lë pa përmendur luftën në Malin e Zi, sakrificat që bënë partizanët Veip Çepani (Goga) dhe Pero Nepravishta, të cilët mbetën invalidë të përjetshëm. Në fitoren që patëm në Zejmen dhe Grykë-Manati, gjatë rrugës dy aleatë anglezë na ndihmuan shumë për të minuar rrugën. Gjithashtu na ndihmuan edhe në Grykën e Moraçës në Malin e Zi. Zbuluesit tanë e kaluan lumin Drinos. Tek partizanët tanë ishte ngulitur thellë dëshira për të vazhduar luftën deri në Berlin. Por pa prituri vjen urdhëri "Divizioni i VI-të të këpues kontaktin me armikun dhe të kthehet në Shqipëri!". Komandanti i Divizionit e lexoi këtë urdhër në të gjithë efektivat dhe proteston: Falë kësaj proteste vjen urdhëri nr.3: "Divizioni të nisat për në Kosovë".

Me rastin e 71 vjetorit të Brigadës kujtojmë me nderim e respekt të gjithë ata që i dhanë jetën kësaj lufte dhe nuk jetojnë më, si: Adil Çarçanin, Gjin Markun, Kadri Hoxhën, Muharrem Fugën, Njazi Demin, Myzafer Trebeshinën, Irfan Peshtanin, Luan Qafëzezin, Mustafa Beqon, Ismail Gjerbësin, Tajar Grepckën, Novruz Gjerbësin, Kajmak Qerimin (Kaloçin), Novruz Malindin, Adil Prishtën, Xhavit Strudën, Habib Seitllarin, Foto Pukën, Mark Çukun, Miti Teneqexhin, Rushit Dervishin e shumë të tjerë.

NDERIMI

18-vjetori i masakrës së Prekazit dhe i rënies heroike të komandantit legjendar, Adem Jashari

Komandanti legjendar Adem Jashari e shndërroi Prekazin në Krujë të dytë


Mbarë kombi shqiptar përulet me nderimin më të thellë para Komandantit legjendar, Adem Jashari, burrit që me trimërinë, guximin mbinjerëzor, shndërroi Prekazin në Krujë të dytë të shqiptarëve. Në këtë 18-vjetor, vepra e ndritur e Adem Jasharit e familjes së tij, shkëlqen më shumë se kurrë

Më 5 Mars do të përkujtojmë 18-vjetorin e masakrës së Prekazit. Në këtë ditë mbarë kombi shqiptar përulet me nderimin më të thellë para Komandantit legjendar, Adem Jashari, i cili me burrërinë, trimërinë dhe guximin mbinjerëzor e shndërroi Prekazin në Krujë të dytë për shqiptarët e Kosovës dhe mbarë kombi ynë festuan 8-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës me kokën lart, me ndjenjën e krenarisë së ligjshme, gjë e cila pa veprën, pa heroizmin, pa sakrificën sublime të Adem Jasharit dhe të gjithë familjes së tij do të ishte e pamundur. Kosova festoi 8-vjetorin e Pavarësisë së saj, në themel të së cilës qëndron sakrificat e burrit, që ra për t'u bërë i pavdekshëm, komandantit dhe kryeheroit të kombit shqiptar, që pasuroi atë shumë altarin e lirisë së kombit tonë.

Më 5 Mars, bashkë me figurën e Adem Jasharit, nderohen dhe mijëra e mijëra, vajza dhe djem, burra dhe gra të Kosovës, të cilët bënë luftën më të vështirë, më të pabarabartë, por dhe më heroike, me të cilën çliruan Kosovën, me të cilën i dhanë fund sundimit barbar të Millosheviçit dhe vendosën Kosovën në anën e Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe Bashkimit Europian.

MË 5, 6 DHE MARS 1998 NË PREKAZ JANË VRARË 56 SHQIPTARË

Më 28 shkurt, në këtë ra-



jon të Drenicës u organizua një sulm i kombinuar i forcave serbe që zgjati 24 orë, ku u angazhuan një numër i madh i policëve, i paramilitarëve dhe i ushtarëve serbë të maskuar. Në atë sulm është përdorur edhe armatimi i rëndë dhe helikopterë. Gjatë këtyre operacioneve në fshatrat e Drenicës, Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë vendosi lidhjen mes Beogradit dhe bazave të veta në Kosovë dhe me helikopterë u sillte ndihmë forcave serbe, që qëlonin pa ndërprerë në fshatrat me popullsi shqiptare.

Civilët shqiptarë janë vrarë e masakruar në shtëpitë e tyre, mosha e të cilëve sillet prej 16 deri në 70 vjeç. Policët janë futur në familjen 36 anëtarëshe të familjes Ahmetaj në Likoshan, ku i

kanë detyruar të gjithë, burra, gra e fëmijë, të shtrihen për tokë, i kanë ndarë meshkujt, i kanë nxjerrë jashtë dverve të oborrit, i kanë rrahur dhe i kanë masakruar një nga një në mënyrën më barbare, aq sa vështirë është bërë identifikimi i tyre.

Pas masakrës së Likoshanit dhe Çirezit, më 5 mars 1998, rreth orës 5.00 të mëngjesit, forcat policore serbe ndërmoren një sulm të kombinuar mbi fshatrat: Prekaz i Poshtëm, Llaushë, Polac, Marinë, Vojnik dhe Rakinicë të Komunës së Skënderajt dhe ky sulm zgjati deri më 7 mars. Më 5, 6 dhe 7 mars 1998 vetëm në Prekaz janë vrarë 56 shqiptarë, prej tyre 21 anëtarë ishin të familjes së ngushtë të Shaban Jasharit. Ndër të vrarët ishin 15 fëmijë,

OBVL uron veteranët e LANÇ të Kosovës në 8-vjetorin e pavarësisë



I nderuar Z. Mulhaxha,

Të nderuar veteranë të LANÇI të Kosovës!

Me rastin e 8 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës më lejoni t'ju përcjell urimet më të përzemërta dhe më të ngrohta në emrin tim dhe në emër të Kryesisë të Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

Sot është një ditë e shënuar për të gjithë shqiptarët, ndaj dhe i gjithë kombi ynë kujton me mirënjohje të thellë vizionarët, heronjtë dhe të gjithë ata që sakrifkuan për pavarësinë e Kosovës në të kaluarën, sakrificë së cilës duhet t'u përgjigjemi me përulesë e përgjegjshmëri për të ardhmen.

Duke qenë krenarë për atë ç'ka është arritur deri më sot, dëshiroj t'ju siguroj, se veteranët e OBVL do të vazhdojnë të qëndrojnë përkrah Kosovës në të gjitha përpjekjet e saj për forcimin e institucioneve demokratike, për avancimin e sigurt në rrugëtimin e saj euro-atlantik, si dhe për të ardhmen e përbashkët për të gjithë qytetarët tanë.

Duke ju shprehur edhe një herë urimet e mia më të ngrohta, si dhe dëshirën për paqe, zhvillim e prosperitet për të gjithë qytetarët e Kosovës, lutem pranoi, i nderuar z. Mulhaxha, ndjenjat e konsideratës time më të lartë.

Gjeneral – lejtënant RRAHMAN PARLLAKU
Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit
Kryetar i OBVL

Tiranë, më 17.02.2016

të moshës 7 deri 16 vjeç dhe 17 femra. Ndër të masakruarit kishte pleq e plaka deri në moshën 74-vjeçare. Të gjitha viktimat e identifikuar dhe të paidentifikuara policia i varrosi më 10 mars, pa respektuar kurrfarë normash të traditës ose të rregullave të varrimit, si dhe pa e bërë obduksionin.

NDERIM TË GJITHË ATYRE QË SAKRIFIKUAN JETËN PËR KOSOVËN

Nderimi është për ata mijëra e mijëra vajza dhe djem, burra dhe gra të Kosovës, të cilët bënë luftën më të

vështirë, më të pabarabartë, por dhe më heroike, me të cilën çliruan Kosovën, me të cilën i dhanë fund sundimit barbar të Millosheviçit dhe vendosën Kosovën në anën e Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe Bashkimit Europian. Aspirata këto, të cilat qytetarët e Kosovës vendosmërisht po punojnë që t'i realizojnë. Edhe një herë nderimin më të madh për komandantin legjendar, për burrin që e shndërroi në Krujë të dytë Prekazin. Nuk ndodh në historinë e kombit tonë, nuk gjendet në historinë e luftërave për liri të Europës një sakrificë kaq madhore, kaq sublime, sa kjo e Adem Jasharit dhe familjes së tij.



DOSSIER

Në përvjetorët e saj Shkolla "Skënderbej" është dekoruar me shumë Urdhëra e Medalje

Shkolla "Skënderbej", trup pedagogjik cilësor dhe studentë të përkushtuar



Ing. Myfit GUXHOLLI

Kur ende nuk ishte shuar jehona e betejave fitimtare kundër okupatorit nazifashist, me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor u çel e para shkollë ushtarake e pionierëve të luftës. Traditat luftarake të popullit tonë brez pas brezi dhe patriotizmi i lartë i pionierëve, pjesëmarrja në luftimet e çetave, batalioneve e brigadave kalitën shpirtin e tyre duke i ndërgjegjësuar për detyrën e re. Kjo bëri që shkolla ushtarake (e kadetëve) të merete fizionominë e një shkolle të mesme.

Kjo shkollë që e nisi rrugën e saj si fidanishte e Ushtrisë Kombëtare u sistemua në ambientet ku është Akademia Ushtarake "Skënderbej". Nxënësit e parë të kësaj shkolle ishin ish partizanët nën moshën 15 vjeçare që vinin nga brigadat partizane dhe ata djem e vajza të dëshmorëve të LANÇ nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Ata erdhën në shkollë me uniformën që mbanin në luftë dhe me armët personale, pushkë, automatikë e pistoletë.

(Ndërsa jo pjesëmarrësit në luftë mbanin uniformën kadife blu). Shkolla përbëhej nga komanda e Shtabi. Komandanti i parë i shkollës ishte Mehmet Dermeni – kapiten i I-rë, komisar toger Dule Pashaj, Shefi i degës mësimore, kapiten i parë Vangjel Doga e kapiten Thoma Frashëri. Në fillim u krijuan tre batalione me komandant e komisar kapiten Shuaip Shazi, kapiten Miço Kola e kapiten Filip Stefani.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

U krijuan dy brigada: brigada e IV-të me studentë ish pjesëmarrës në luftë, me komandant Myfit Guxholli dhe komisar Gafer Shyti; (komandant i batalionit të parë Vasfi Rexhepi).

Brigada e I-rë me uniformë kadife blu: Ylber Sevriani, komandant dhe Xhevrë Golemi, komisar...Batalioni i parë, komandant Qemal Tuzi dhe Faik Meko. Veçojmë studentet partizane Veronika Murzaku, Katerina Prifti etj.



INAGURIMI I SHKOLLËS

Në inagurimin e shkollës më 28 Mars 1945 mori pjesë gjeneral major Spiro Moisiu – komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Skënderbegasit, pjesëmarrës në luftë, armët i mbanin nën jastëk dhe nuk i dorëzonin në depo. Nga komanda e shkollës dhe ajo e studentëve u përgatit një lojë për marrjen e armëve të studentëve. Në malin e Dajtit ishte shkruar një parullë fashiste me germa të mëdha "DVX" që duhej prishur. Në vend të saj duhej një parullë e re. Shkuam në malin e Dajtit, zbatuam detyrën dhe u kthyem në shkollë, kur ç'të shohim: armët ishin mbledhur e dorëzuar në depo. Pakënaqësia dhe nervozizmi ishte i madh.

RIORGANIZIMI

Në 5-vjetorin e saj shkolla u riorganizua dhe u përpiluan programet dhe tekstet. Për fatin e mirë u plotësua trupi pedagogjik dhe ai komandues. Shumica e pedagogëve ishin të përgatitur në shkollat e Perëndimit. Me respekt kujtojmë pedagogët: Barie Koplaku, Halit Narazuni, Hysni Alimerko, Ahmet Tufa, Eftimiadhi, Stavri Angjeli, Valeria Drenova e shumë të tjerë. Puna e kualifikuar e trupit pedagogjik dhe komandës, përkushtimi i nxënësve dhe studentëve bindën

Trupi pedagogjik cilësor dhe studentët e përkushtuar, kabinetet e reja, laboratorët, ambientet e komandës dhe të një jetese normale bënë që shkolla "Skënderbej" të rriste treguesit cilësorë dhe sasiorë. Cilësitë dhe virtytet e skënderbegasve si besa, trimëria, solidariteti, dashuria e devotshmëria për Atdheun, familjen e shokun ishin më të çmuarat për skënderbegasit që në çdo çast ecnin në gjurmët e lavdishme të LANÇI.

drejtuesit e Ministrive të Arsimit dhe Mbrojtjes që shkolla të vlerësohej dhe të merrte emrin "Shkolla e Mesme Ushtarake Skënderbej". Për arsyen se shkolla nuk kishte klasa të dyta e të treta të mesme, skënderbegasit dërgoheshin në gjimnazin "Qemal Stafa" si psh Pavlo Dede, Myfit Guxholli, Agron Starova etj. Trupi pedagogjik cilësor dhe studentët e përkushtuar, kabinetet e reja, laboratorët, ambientet e komandës dhe të një jetese normale bënë që shkolla "Skënderbej" të rriste treguesit cilësorë dhe sasiorë. Cilësitë dhe virtytet e skënderbegasve si besa, trimëria, solidariteti, dashuria e devotshmëria për Atdheun, familjen e shokun ishin më të çmuarat për skënderbegasit që në çdo çast ecnin në gjurmët e lavdishme të LANÇI. Këto cilësi e virtyte u demonstruan më së miri gjatë provokacionit të gushtit kur monarkofashistët grekë tentuan të preknin kufirin tonë shtetëror. Shumë skënderbegas kërkuan të shkonin vullnetarisht në mbrojtje të kufirit, por Ministria e Mbrojtjes konsideroi pjesërisht kërkesën e tyre.

NJË SHKOLLË SHUMËDIMENSIONALE

Në përvjetorët e saj Shkolla "Skënderbej" është dekoruar me shumë Urdhëra e Medalje. Pedagogët, komanduesit dhe studentët e kësaj shkolle kanë dhënë një kontribut të madh

edhe në sektorë të tjerë si në art, sport, kulturë, diplomaci e shkencë. Pikërisht për këtë e meriton të quhet shkollë shumëdimensionale. Krenaria dhe lavdia e saj u përhap në gjithë vendin sepse moto e saj ishte "Atdheu mbi të gjitha". Ajo u dallua për ndjenjë patriotike dhe dije në shërbim të Atdheut. Nga kjo shkollë kanë dalë jo vetëm kadro ushtarake të të gjitha rangleve, por edhe të sektorëve të tjerë pasi ajo ishte jo vetëm një fidanishte e Ushtrisë Kombëtare, por edhe përhapëse e dijes e kulturës në të gjitha fushtat e jetës. Ajo ka përgatitur e nxjerrë nga nëntogerë deri gjeneralë, nga teknikë deri doktorë e profesorë. Në këtë përvjetor jubilar të saj ia vlen të përmendim skënderbegasit: Luan Rama, ish ministër i Mbrojtjes, Bujar Nishani, ministër, gjeneral Kostaq Karoli, ish shef i Shtabit të Përgjithshëm, kandidati i Shkencave Ushtarake Pandeli Stoja, prof.Dr.Përparim Lika, dhe prof. dr.Eduard Iusfi. Po ashtu shef shërbimi Ing.Nuri Jaho, studjues e përkthyes Ing.Guri Shyti, shef katedre Ing. Pasho Alimerko, mjeshtër sporti-shef katedre, kolonel Petrit Murzaku, shef katedre – kolonel tankist Aleko Koka, pilot i klasit të parë – komandant Aki Jupasi, pilot i klasit të parë Petrit Malindi, komandant korpusi Izet Murati etj. Në plejadën e personaliteteve që ka nxjerrë kjo shkollë bëjnë pjesë shkrimtari Shpend Topollaj, shefi i shërbimit topografik Gafer Shyti, shef shtabi grupimi Dr. as. Mik Hado, kolonel Ylber Sevriani (kuader i lartë i marinës ushtarake), Prof.Dr.Gjergji Aleksi, kolonel Proletar Hasani (historian), gjeneral major Armando Vinçani, artistët Milto Vako e Ndrek Zefi, sportisti Petrit Çallsi, shef shërbimi n/kolonel Hiqmet Shehi, diplomati Hajro Limaj (kolonel), kolonel Xhavit Xhepa-Drejtor i Drejtorisë së Xhenjos e shumë të tjerë.

Në ish skënderbegasit e parë, jemi krenarë që mbaruam atë shkollë, duke vazhduar më pas edhe shkolla të larta, universitete dhe akademi, brenda dhe jashtë vendit. Përsëhendesim në këtë jubile të saj tupin pedagogjik, komandant e shkollës dhe gjithë oficerët që na edukuan dhe mësuam. Nder dhe lavdi heronjë e dëshmorëve të luftës e pas luftës.

**Ish komandant i Brigadës së skënderbegasve të luftës*



HISTORIA

Kuvendi vendosi komandant të përgjithshëm Skënderbeun, duke njohur autoritetin e tij politik dhe ushtarak “Besëlidhja e Lezhës”, Kuvendi ku u hodhën themelet e bashkimit kombëtar

Kuvendi i Lezhës, i mbajtur në 2 mars të vitit 1444 nën drejtimin e Gjergj Kastriot Skënderbeut, ishte një hap shumë i rëndësishëm për të përkthyer bashkimin politik të principatave të vendit dhe krijimit të një pushteti qëndror për të gjitha viset e lira shqiptare, pushtet që u zhvillua ndjeshëm duke krijuar në mbretëritë dhe kancelaritë e vendeve të huaja imazhin e një vendi me integritet politik dhe territorial. Si i tillë u cilësua Kuvendi i Lezhës në këtë 565 vjetor, që u kremtua me një ceremoni në katedralen e Kishës së Shën Kollit në qytetin e Lezhës, ku shekuj më parë u mbajt ky Kuvend dhe ku tashmë gjendet memoriali i Gjergj Kastriot Skënderbeut. Ceremonia nisi me një imitacion të skuadrës së kalorësve mbi periudhën e Skënderbeut dhe më pas autoritetet e pranishme bënë një parakalim në sheshin përpara memorialit të Heroit tonë Kombëtar. Pjesë e ceremonisë ishin dhe homazhet dhe vendosja e kurorave me lule pranë varrit të Skënderbeut. “Ideja dhe nevoja për mbajtjen e një kuvendi, me përfaqësi nga të gjitha principatat e trojeve shqiptare, erdhi fill pas fitores së madhe të vitit 1443, kur Skënderbeu filloi takimet me princër e fisnikë të tjerë shqiptarë për të gjetur rrugën e bashkimit, pa të cilën s’mund t’i bëhej ballë superfuqisë ushtarake dhe politike të asaj kohe, siç ishte Perandoria Osmane”, thanë referuesit në këtë përvojë. Sipas tyre, Lezha kishte një pozicion gjeografik të favorshëm për mbajtjen e Kuvendit. Ajo ndodhej në afërsi me qytetet dhe pjesëmarrësve kryesorë të Kuvendit,



Besëlidhja e Lezhës përbën një prej ngjarjeve më të rëndësishme të historisë së mesjetës. Më pas, ky bashkim i popullit shqiptar do të përsëritej, kur në vitin 1878 do të mbahej Lidhja e Prizrenit, e më pas në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare, Konferenca e Pezës. Në të gjitha këto lidhje ideja themelore ishte bashkimi pa dallim feje, krahine dhe pikëpamje politike i shqiptarëve për çështjen kombëtare

ishte e veçuar nga zotërimet e tjera të Venedikut dhe kishte lidhje të ngushta ekonomike me viset e çirruara shqiptare, veçanërisht me ato të Kastriotëve. Vendime dhe fakte interesante nga historia e Kuvendit të Lezhës dhe krijimit të Besëlidhjes Shqiptare sollë dhe Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Kasem Biçoku. Emocione të veçanta krijuan aktorët e mirënjohur Yllka Mujo dhe Ndrim Xhepa, të cilët recituan vargje kushtuar Kuvendit të Lezhës dhe Heroit Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu. Pjesëmarrësit në këtë ceremoni vizituan më pas një ekspozitë të hapur në

medjet dhe Pallatit të Kulturës së qytetit, kushtuar kësaj ngjarjeje të rëndësishme.

HISTORIKU

572 vite më parë, në Katedralen e Kishës së Shën Kollit në qytetin e Lezhës, ku sot gjendet dhe memoriali i Gjergj Kastriot Skënderbeut, u mbajt Besëlidhja e Lezhës, një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar gjatë periudhës së mesjetës. Ishte 2 marsi i vitit 1444, kur Gjergj Kastriot Skënderbeu, menjëherë



pas kthimit nga Turqia, për herë të parë në historinë e mesjetës shqiptare mbledhi në një kuvend të gjitha principatat shqiptare, me qëllim përbashkimin e sulmit otoman. Pikërisht, realizimi i bashkimit të gjithë princërve shqiptarë, në një kuvend të përbashkët nga ana e Skënderbeut, përbën edhe idenë më të madhe novatore të tij. Studiu dhe historianë thonë se bashkimi i shteteve të copëtuar feudale ka qenë një ide, e cila është realizuar me vështirësi edhe në vende të mëdha të Europës. Kështu, Italia është bashkuar në shekullin e XIX në kohën e Garibaldi, ashtu sikundër edhe Gjermania u bashkua gjatë shekullit të XIX në kohën e Bismarkut. Në Kuvendin e Lezhës u mbledhën principatat shqiptare nga veriu në jug, ku më të rëndësishmet ishin Arianitasit, Dukagjinastit, Balshajt dhe Topiajt, ndërsa nga pikëpamja ballkanike në të mori pjesë dhe princi i Malit të Zi. Kuvendi vendosi komandant të përgjithshëm të Lidhjes Skënderbeu, duke njohur autoritetin e tij politik dhe ushtarak. Që prej këtij bashkimi udhëheqësi legjendar rriti rezistencën e ushtrisë së tij dhe drejtoi luftën për 25 vjet me radhë. Po t’i referohesh dokumentacionit historik, kuvendi i Besëlidhjes nuk u mbajt rastësisht në qytetin e Lezhës, i cili në atë kohë ishte në zotërimin e Venedikut. Kjo ngjarje e rëndësishme u zhvillua në këtë qytet, pasi Lezha nuk përfaqësonte kryeqendrën e principatave dhe në këtë mënyrë shmangeshin grindjet e mundshme dhe krijohje ideja e barazisë. Kjo është cilësuar nga shumë figura të asaj kohe edhe si një nga veprimet diplomatike të Skënderbeut. Kuvendi u mbajt në Lezhë, duke ditur faktin se, Lezha me anë të pushtetit venedikas do të shërbente edhe si faktor përkrahjeje në Europë, pasi një nga idetë më të mëdha të Lidhjes ishte integrimi i Shqipërisë në Europën perëndimore. Besëlidhja e Lezhës përbën një prej ngjarjeve më të rëndësishme të historisë së mesjetës. Më pas, ky bashkim i popullit shqiptar do të përsëritej, kur në vitin 1878 do të mbahej Lidhja e Prizrenit, e më pas në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare, Konferenca e Pezës. Në të gjitha këto lidhje ideja themelore ishte bashkimi pa dallim feje, krahine dhe pikëpamje politike i shqiptarëve për çështjen kombëtare.

Zv.ministri i Mbrojtjes Petro Koçi, takim me nxënësit e gjimnazit “Havzi Nela”, Kukës

Të bëhesh pjesë e FA është krenari sepse i shërben atdheut

Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, në vijim të takimeve që po zhvillohen nga Ministria e Mbrojtjes në kuadër të fushatës sensibilizuese për rekrutimin në FA, u takua me nxënësit e gjimnazit “Havzi Nela” në Kukës.

Në fillim nxënësit i ka përshëndetur komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani, i cili është bir i kësaj zone. Ai vlerësoi ushtarakët që shërbejnë në FA dhe që vijnë nga Kukësi, ku ndër të tjerë përmendi edhe djalin e drejtorit të Drejtorisë Arsimore të këtij qarku, që shërben në FA. Të bëhesh pjesë e FA është krenari sepse i shërben atdheut, por edhe paqes në botë, është shprehur gjeneral brigade Cahani.

Duke marrë fjalën në këtë takim, zv.ministri i Mbrojtjes Petro Koçi, theksoi se, ndjehet krenar dhe i emocionuar që ndodhet sot në Kukësin legjendar të mikëpritjes dhe të shqiptarizmit. “Kur ujen në Kukës, na mbushet shpirti edhe më shumë me dashuri për atdheut, për Shqipërinë e për Kosovën. Dhe kjo është

në radhë të parë meritë e kuksianëve që sidomos në vitin e vështirë kombëtar 1999, ia diti t’i bënte ballë detyrës, duke mikëpritur vëllezërit dhe motrat tona nga Kosova, në atë situatë të vështirë të spratimit etnik të regjimit të Millosheviçit”.

Duke u ndalur në rekrutimin në FA, ai theksoi se, kriteri i parë që të jesh në Forcën tonë të Armatosur është që ta duash më shumë se të tjerët flamurin tonë kuqezij, flamurin tonë kombëtar. Dhe kjo garanci është, natyrisht, në radhë të parë në Kukës, prandaj ne vijmë këtu duke ju parë në sy dhe duke ju ftuar që të bëheni pjesë e Forcës tonë të Armatosur, sepse nuk do të jetë vetëm mirë për ju, por do të jetë mirë edhe për Republikën e Shqipërisë.

Më tej, z. Koçi tha se, në çdo sondazh që është bërë pjesa më e respektuar e shtetit mbetet FA, mbetet ushtaraku. Kjo ndodh sepse ushtarakët, ndryshe ndoshta nga pjesa tjetër e strukturës shtetërore apo dhe shoqërore, shpallsin gjithmonë,

së pari, vlera morale të jashtëzakonshme, vlera kombëtare, vlera të gatishmërisë për të përbaluar misionet, detyrat sidomos në rastet e emergjencave, të cilat kanë ndodhur edhe në Kukës kur ka pasur reshje të shumta dëbore, përmbajtje apo zjarre gjatë verës dhe kjo e ka ritur respektin e komunitetit për FA. Prandaj është një shans shumë i mirë që ju jepet për të qenë pjesë e kësaj force, sepse do të jeni pjesë e një strukture të ndënuar dhe të respektuar nga publiku, ka nënvizuar z. Koçi.

Në vijim, zv.ministri i Mbrojtjes, theksoi se, ne jemi krenarë kur marrim vlerësimet nga vendet aleate për rolin që luajn ushtarakët tanë në misionet ndërkombëtare. “Natyrisht që janë misionet me reziqe që kërkojnë djem dhe vajza që kanë kurajo, që kanë adrenalinë për ta bërë dhe për ta përbaluar rrezikun. Shumë prej jush do të jenë pjesë e FA do të bëhen forca Komando, mund të jenë pjesë e Forcave Speciale, mund të jenë detarë që do të përballojnë reziqet e detit, mund të jenë pilotë të helikopterëve që do të përballojnë reziqet e motit, do të jenë pjesë e misioneve që shpëtojnë jetë njerëzish në operacionet e kërkim-shpëtimit. Prandaj mendoj se po të jeni pjesë e FA do të jeni edhe më të rëndësishëm dhe ne duam që ju ta luani këtë rol të rëndësishëm”, - ka përfunduar zv.ministri i Mbrojtjes.

Në këtë takim zv.ministri i Mbrojtjes Petro Koçi është shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani, komandanti i QPR-së, kolonel Leonard Çoku, drejtori i Drejtorisë Arsimore të qarkut të Kukësit, drejtori i gjimnazit “Havzi Nela” etj.



GENOCIDI

Masakra e pashembullt e 19 shkurtit 1951: U kërkua të arrestoheshin 100 ose

65 vjet më parë – Si u ekzekutuan

Nga Halil RAMA

Pas të ashtuquajturës “bombë në Ambasadën Sovjetike”, klika kriminale në krye të PPSH e qeverisë komuniste urdhëroi marrjen e masave të jashtëzakonshme represive “pa marrë parasysh ligjet në fuqi”! Mehmet Shehu që urdhëroi një represion të tillë të paparë do të shprehej se, “Një masë të tillë ne e kemi marrë edhe kur u vra Bardhok Biba, dmth kemi pushkatuar edhe jashtë ligjeve në fuqi”. Ministri i Brendshëm kërkoi nga Byroja Politike që arrestimet të bëheshin qysh atë natë, pa bërë hetime për ngjarjen dhe pa gjetur provat për personat e pandehur.

HISTORIA

Gjashtëdhjetëpesë vjet më parë, më 19 shkurt 1951, në orën 17 e 47 minuta u hodh në oborrin e ndërtesës së Ambasadës Sovjetike një sasi e vogël dinamiti me potencial të reduktuar. Një krisje e fortë dhe disa xhama të thyer. Asgjë më shumë. Alarm në Ministrinë e Brendshme dhe në qarqet e larta politike të Tiranës. Shqetësimin në Ambasadën Sovjetike të Tiranës dhe në Ministrinë e Jashtme të BS.

Plenumi i KQ të PPSH i ndërpreu përkohësisht punimet në paraditen e datës 20.02.1951, sepse u mbledhën urgjentisht Byroja Politike e KQ të PPSH, që mori në shqyrtim incidentin e rëndë në Ambasadën Sovjetike.

Në seancën e datës 20 shkurt 1951, Byroja Politike e KQ të PPSH dëgjoi raportimin e ministrit të Brendshëm, Mehmet Shehu. Ai e cilësoi këtë ngjarje, “Një politikë të kalibrut të madh, madje më e madhe se një atentat që mund të bëhej kundër ndonjërit nga ne”.

MASA TË JASHTËZAKONSHME REPRESIVE “PA MARRË PARASYSH LIGJET NË FUQI”!

Pas të ashtuquajturës “bombë në Ambasadën Sovjetike” klika kriminale në krye të PPSH e qeverisë komuniste urdhëroi marrjen e masave të jashtëzakonshme represive “pa marrë parasysh ligjet në fuqi”! Mehmet Shehu që urdhëroi një represion të tillë të paparë do të shprehej se, “Një masë të tillë ne e kemi marrë edhe kur u vra Bardhok Biba, dmth kemi pushkatuar edhe jashtë ligjeve në fuqi”. Ministri i Brendshëm kërkoi nga Byroja



Politike që arrestimet të bëheshin qysh atë natë, pa bërë hetime për ngjarjen dhe pa gjetur provat për personat e pandehur.

U kërkua të arrestoheshin 100 ose 150 vetë, nga të cilët 10 ose 15 të rëndësishëm të pushkatoheshin pa gjyq. Përveç kësaj, Mehmet Shehu do të kërkonte që, “Kjo masë do të procedohet edhe me një masë tjetër spastrimi nga Tirana të familjeve reaksionare brenda një muaji”.

Ministria e Brendshme dhe siguria i shtetit përpiloi listën e vdekjes, arrestimin dhe pushkatimin e 22 viktimave (edhe këto nga datat 19-26 shkurt 1951)

KUSH I PËRPILOI TRI LISTAT ME 22 PERSONA TË ZGJEDHUR PËR T’U EKZEKUTUAR PA GJYQ?

Kryetari i degës së dytë të Sigurimit të Shtetit, kapiten Rasim Dedja, hartuasi i listave ka rrëfyer se, “Vlerësimi për personat që do të pushkatoheshin dhe që janë pushkatuar në fakt, është bërë direkt nga udhëheqja e Ministrisë, që në atë kohë ka qenë Mehmet Shehu me dy z.v.ministrat Kadri Hazbiu dhe Mihallaq Zicisht”

AKUZA

Akuza e Prokurorit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Siri Çarçani mban datën 25.02.1951 dhe është firmosur prej tij.

Akt akuzës fillon me emrin e të pandehurit Tefik Shehu dhe mbaron me emrin e Sabiha Kasimatit. Gjithsej 22 persona të akuzuar. Për çdo akt akuzë, për çdo të akuzuar, shënohen gjeneralitetet, shtrresa shoqërore dhe data e arrestimit. Asgjë tjetër.

AKUZA KOLEKTIVE

“Akuzohen se: Janë vënë në shërbim të spiunazheve të huaja imperialiste, duke u bërë agjentë të rregullt të tyre. Kanë furnizuar spiunazhet e huaja me informata me karakter sekret ushtarak, politik dhe ekonomik në dëm të Republikës sonë Popullore;

- Janë bërë anëtarë të një organizate terroriste.

- Kanë propaganduar për rrëzimin me dhunë të pushtetit popullor dhe kanë hedhur parrulla pro shpërthimit të një lufte të re nga ana e imperialistëve amerikano-anglezë dhe satelitëve të tyre.

Fajet e mësipërme sipas Prokurorit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Siri Çarçani parashikoheshin nga nenet 2 e 3 Nr.10,7 dhe 8 të Ligjit 372 datë 12.12.1946 mbi fajet penale kundër popullit dhe shtetit dhe dënohen nga neni 4 i po këtij ligji.

Duke qenë se ky proces konsiderohet me rëndësi të posaçme, ai kërkoi që “Në bazë të nenit 12 të paragrafit të dytë të ligjit të sipërpërmendur të gjykohej në seancë të parë e të fundit direkt nga Gjykata e Lartë Ushtarake dhe, mbasi të dërgohet para gjyqit dhe të provohet fajësia e tyre, të dënohen sipas dispozitave të sipërpërmendura”.

PROCES ME “RËNDËSI TË POSAÇME” DHE NJË AKUZË VETËM 10 RRESHTA

Ky proces me “rëndësi të posaçme” dhe 22 persona të pandehur ngre një akuzë vetëm 10 rreshta.

-Së pari, sipas aktakuzës, të pandehurit “janë vënë në shërbim të spiunazheve të huaja, duke u bërë vegla të rregullt të tyre”.

-Kjo akuzë nuk mbështetet nga kryeprokurori me asnjë provë.

Së dyti, sipas aktakuzës, të pandehurit “janë bërë anëtarë të një organizate terroriste”. Në dosjen 1687 nuk posedohet asnjë provë për një organizatë terroriste apo ndonjë akt terrorist të saj, madje as nuk përmendet as hedhja e bombës në Ambasadën Sovjetike, pasi asnjë prej të pandehurve nuk kishte lidhje me këtë akt terrorist.

Nuk u provua të kenë lidhje me njëri-tjetrin, madje ata dëshmuar se as që e njohin njëri-tjetrin. Sipas Procesverbalit të gjyqit të gjithë mohojnë: “Nuk pranoj të kem bërë akt terrorist”/ “Unë vetë nuk kam kryer ndonjë atentat dhe as që kam marrë pjesë në ndonjë mbledhje, ku është marrë vendim për akte terroriste”/ “Nuk kam marrë pjesë në ndonjë organizatë terroriste”/ “nuk pranoj akuzën që të kem

marrë pjesë në një organizatë terroriste”.

-Aktakuza e tretë e Prokurorit të Përgjithshëm: “Kanë propaganduar për rrëzimin me dhunë të pushtetit popullor dhe kanë hedhur parrulla pro shpërthimit të një lufte të re nga ana e imperialistëve amerikano-anglezë dhe satelitëve të tyre”.

Të gjithë të akuzuarit pranuan pjesërisht akuzën me këtë frazë: “Kemi shpreuar tek një ndërhyrje e anglo-amerikanëve dhe tek një luftë e re, që do ta ndryshonte situatën”, kjo fjali mendohet prej studiuesve të jetë shtuar nga oficerët e Sigurimit të Shtetit, që kishin dorë të lirë të shkruanin çfarë të donin.

GJYQI INEKZISTENT

A u zhvillua ndonjë gjyq, qoftë dhe formal dhe a është marrë ndonjë vendim gjyqësor për dënimin me vdekje të 22 jetëve?

-Ekziston procesverbali, provë shkresore se është përpiluar pasaktësisht më vonë, pas pushkatimit të viktimave dhe pa gjykim?

-Në procesverbal thuhet se, çështja ishte shqyrtuar në bazë të ligjit të ri mbi organizatat terroriste, pa përmendur se cili ishte ai ligj, numri dhe data e daljes së tij.

-Në procesverbal thuhet, se u lexua akuzat dhe u morën në pyetje të pandehurit. Por, nuk thuhet se kush e lexoi akuzën, mbasi prokurori mungonte.

Në procesverbal nuk jepet trajtimi i çështjes nga kryetari i trupit gjyqësor i kryesuar nga kryetari i trupit gjyqësor dhe përgjigjet e secilit për pyetjet. “En block” janë shkurt “reagimet” e secilit të pandehur për akuzën.

-Nuk evidentohen në procesverbal pyetjet që bënë trupi gjyqësor dhe përgjigjet e secilit për pyetjet. “En block” janë shkurt “reagimet” e secilit të pandehur për akuzën.

NUK KA PASUR DOSJE HETIMORE GJYQËSORE PËR NGJARJEN E BOMBËS NË AMBASADËN SOVJETIKE

Ish-anëtar i Gjykatës së Lartë, Mustafa Qilimi ka deklaruar: “Sa kohë isha unë në Gjykatën e Lartë nuk ka pasur dosje hetimore gjyqësore për ngjarjen e bombës në Ambasadën Sovjetike, për të cilën ekziston vendimi i pushkatimit të 22 personave”.

Të gjitha janë shkelje të ligjit, që dëshmojnë se gjyqi nuk është zhvilluar fare.

- Procesverbalet janë plotësuar nga Gjykata e Lartë dhe Ministria e Brendshme, pas ekzekutimit të personave të arrestuar.

- Prova se procesverbali është falsifikuar është rasti i Jonuz Kacelit: vritet gjatë torturave, hidhet nga dritarja si i vetëvranë – rast që merret si i pandehur në gjyq, pyetet nga kryetari, u përgjigjet akuzave dhe dënohet me vdekje, kjo provon se procesverbali është shkruar më vonë, gjyqi nuk është zhvilluar si fund të tij.

Vendimi “me vdekje me pushkatim” ishte i formës së prerë, i paapelueshëm, i ekzekutuar menjëherë dhe i plotësuar me konfiskimin e gjithë pasurisë së lua-

GENOCIDI

150 vetë, nga të cilët 10 ose 15 të rëndësishëm do të pushkatoheshin pa gjyq pa gjyq 22 intelektualë



jtshme e të paluajtshme, deri te lugët dhe pirunjt!

POROSIA PËR GJYQTARËT E DIKTATURËS: "DUHET TË MBYLLET GOJA E TË MOS THUHET ASNJË NJERIU SE ËSHTË SEKRET I MADH SHTETËROR"

Gjyqtarët e inkriminuar gjer në palcë të kohës së diktaturës ishin porositur nga kupola e qeverisë komuniste, që për këtë vendim penal fiktive "duhet të mbyllet goja e të mos thuhet asnjë njeriu se është sekret i madh shtetëror".

-Shuaip Panariti dhe Vangjel Koçani e firmosin procesverbalin e falsifikuar pa asnjë hezitim. Kundërshtojnë Sekretari i Gjykatës së Lartë, Hydaj Bejo dhe Nonda Papuli

-Në vitin 1991, Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë pas kërkesës pranë Plenumit të Gjykatës së Lartë për prishjen e vendimit penal Nr.64 datë 27.02.1951 si të kundërligjshëm dhe të pambështetur në asnjë provë, u vendos prishja e këtij vendimi dhe pushoi çështjen penale në ngarkim të 22 të pushkatuarve.

Pavarësisht këtij vendimi, ende është mbuluar inekzistenca e gjyqit dhe falsifikimi i dokumenteve gjyqësore.

EKZEKUTIMI

-Mesnatën e 26 shkurt 1951, të 22 personat e shënuar për t'u pushkatuar i nxorën nga qelitë e burgut të lidhur në pranga dhe i nisën në një kamion të mbuluar diku.

-Nuk e dinin se ku do t'i çonin. Nuk e dinin se do t'i vrisnin. Nuk ishte komunikuar urdhëri i pushkatimit. Megjithatë e ndjenin.

-Një ditë para pushkatimit shkollon në burg Mehmet Shehu dhe u foli të arrestuarve: "do të writeni pa mëshirë si kundërshtarë të pushtetit, ndërsa ata që do të mbeten gjallë do të pësojnë të njëjtin fat po të lëvizin bishtin!"

-Afer Urës së Beshirit në fshatin Mënik të Tiranës, rrëzë një kodrine të vogël buzë Erzenit, ishte hapur ditë më parë një gropë e stërmadhe rreth 4.5 metra e gjatë, 3 metra e gjerë dhe 1.5 metra e thellë.

EMRAT E INTELEKTUALËVE QË U PUSHKATUAN MË 26 SHKURT 1951:

Sabiha Kasimati, Tefik Shehu, Pjerin Guraziu, Jonuz Kaceli, Anton Delhysa, Haki Kodra, Gafur Jegeni, Myftar Jegeni, Manush Peshkëpia, Reiz Selfo, Qemal Kasaruho, Zyhdri Herri, Gjon Temali, Petro Konomi, Niko Lezo, Pandeli Nova, Thoma Katundi, Mehmet Shkupi, Ali Qorraliu, Fadil Dizdari, Hekuran Troka, Lluka Rashkoviç.

Sabiha Kasimati, 38 vjeçe. E lindur në Edërne të Turqisë, e diplomuar në Itali. Megjithëse iu ofrua një vend pune në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ajo vendosi të kthehej në atdhe. Punoi në Institutin e Shkencave, duke qenë i njohur kontributi i saj në këtë fushë.

Tefik Shehu, 39 vjeç, i lindur në Gjakovë. I diplomuar në Zagreb për Ekonomi, Financë dhe Drejtësi. Në vitin 1939 u vendos e punoi në Tiranë. Pas pushtimit të Shqipërisë u kthye në Gjakovë. Atje u arrestua nga serbët, por mundi të shpëton te me ndihmën e nacionalistëve shqiptarë. Më 1945, u arrestua nga komunistët shqiptarë në Tiranë, por me ndihmën e avokatit Koço Dilo, shpëtoi nga pushkatimi. Më 26 shkurt 1951, ishte urdhër i prerë për t'u pushkatuar.

Pjerin Guraziu, 45 vjeç, i lindur në Shkodër. Doktor i Shkencave Ekonomike, sportist me rezultate të nivelit ndërkombëtar. Pedagog në shkollën Tregtare të Vlorës. Drejtor i Doganës së Tiranës më 1938. Pas luftës, shëf Finance në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Bujqësisë. Anëtar i komisionit për organizimin e garave atletike në Ballkaniadën e vitit 1946. Jonuz Kaceli 43 vjeç, u lind në Tiranë, në familjen e madhe patriotë të Kacelëve, e njohur për shërbime në dobi të atdheut, në ekonomi, kulturë, art etj. Ky njeri u dërgua në gropën e vdekjes, pasi ishte vranë më parë nga torturat.

Anton Delhysa, 47 vjeç. U lind në Prizren, specialist ndërtimi, kreu me përfundime të shkëlqyera Shkollën Teknikë të Fulcit. Njehet si drejtues i punimeve për ndërtimin e Shkollës Amerikane në Golem të Kavajës, të Shkollës Teknikë të Fulcit dhe të Ambasadës Amerikane në Tiranë. Pas

luftës, drejtoi punimet për ndërtimin e fabrikës së sheqerit në Maliq, për Spitalin në Gjirokastrë, për fabrikën e tullave në Vorë etj. Për punën e tij, u dekorua edhe nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, së fundi edhe me pushkatim...

Haki Kodra, 30 vjeç. U lind në Dibër të Madhe. Pasi u diplomua për Ekonomi në Universitetin e Zagrebit, u kthye në Dibër, ku ngriti një biznes të madh, por u luftua nga serbët, ndaj u largua dhe u vendos më 1940 në Tiranë. Pas luftës punoi në sektorin ekonomik deri në vitin e pushkatimit 1951.

Gafur Jegeni, 41 vjeç. U lind në Dibër. Kreu studimet e larta në Akademinë Ushtarake në Itali. Nga viti 1935-1937, komandant i kufirit bregdetar në Shqipëri. Në ditët e prillit 1939 në Vlorë, me gradën kapiten, kreu detyrën si patriot për mbrojtjen e atdheut. U arrestua dhe gjyqi ushtarak e dënoi me vdekje, më pas u internua në Ventotene. U lirua nga anglo-amerikanët më 1943. Pas kësaj u tërhoq nga ushtria deri në shkurt të vitit 1951.

Myftar Jegeni, 36 vjeç. U lind në Dibër. Kreu Akademinë Ushtarake më 1937 në Itali. Me gradën kapiten më 7 prill 1939, luftoi në Durrës për mbrojtjen e atdheut, më pas edhe kundër ushtrisë gjermane. Kundërshtoi masakrat jugosllave, ndaj serbët, pasi e arrestuan e dërguan në duart e komunistëve në Shqipëri. Pas prishjes së marrëdhënies me Jugosllavinë, punoi si llogaritar në një ndërmarrje ndërtimi në Tiranë, deri në vitin 1951.

Manush Peshkëpia, 39 vjeç, poet, patriot, me origjinë nga Gjirokastra, u lind në Vlorë. Analistë e letërsisë e rendisin krahas me Fishtë, Poradecin, Koliqin, Kutelin etj.

Reiz Selfo, u lind në Gjirokastrë. U shqua si një nga sipërmarrësit e aftë në tregti dhe në ndërtim. Disa nga veprat, si Firma "Selfo" në Vlorë, Ura e famshme e Dragotit mbi lumin Vjosë, Ura e Bënçës në Tepelenë, disa shkolla, ndër to, Gjimonazi në Gjirokastrë dhe shumë të tjera.

Qemal Kasaruho, 49 vjeç. U lind në Gjirokastrë. Ekonomist, zotëruar i disa gjuhëve të huaja, Në vitet '20-'40 punoi si kryeinspektor në doganën e Sarandës, më pas drejtor i përgjithshëm i Monopoleve dhe i Tatimeve në Ministrinë e Financave, ndër kohë mori pjesë në luftën kundër pushtuesve italo-gjerman. Pas luftës nuk u pranua të punonte si ekonomist në Tiranë, por jashtë saj, në minierën e Rubikut.

Zyhdri Herri, 30 vjeç. U lind në Tiranë. Studioi në Liceun e Korçës dhe në Gjimonazin e Tiranës, më pas vazhdoi studimet për drejtësi. Gjatë luftës bashkëpunoi me Frontin N.Ç. Pas luftës, kryeredaktor i gazetës "Bashkimi" në Tiranë. Më pas e priste pushkatimi pa gjyq, e pa faj.

Gjon Temali, 47 vjeç. U lind në Shkodër. Në vitet '40 studioi për Farmaci në Universitetin e Firences. Nga viti 1946 deri në shkurt të vitit 1951, farmacist në Spitalin e Tiranës. U pushkatua si "terrorist", pa gjyq.

Petro Konomi, 30 vjeç. U lind në Kajoro. Kreu studimet e larta në Turqi, në Robert Kolezh, mandej në Akademinë Ushtarake në Itali. Gjatë luftës përkra-

Ukërkuar të arrestoheshin 100 ose 150 vetë, nga të cilët 10 ose 15 të rëndësishëm të pushkatoheshin pa gjyq. Përveç kësaj, Mehmet Shehu do të kërkonte që, "Kjo masë do të procedohet edhe me një masë tjetër spastrimi nga Tirana të familjeve reaksionare brenda një muaji". Ministria e Brendshme dhe Sigurimi i Shtetit përpiloi listën e vdekjes, arrestimin dhe pushkatimin e 22 viktimave (edhe këto nga datat 19-26 shkurt 1951)

hu Frontin N.Ç. Pas luftës u emërua në ATSH.

Niko Lezo, 50 vjeç. U lind në Delvinë. Kimist. Zotëruar i disa gjuhëve të huaja. Ka kryer Universitetin e Tulluzës në vitin 1921. Më 1923, ngriti të parin laborator kimik në Tiranë. Po atë vit, zgjidhet deputet i Delvinës. Më 1940, arrestohet e internohet në Ventotene. Pas luftës punon sërish kimist në laboratorin, tashmë nën vartësinë e Ministrisë së Shëndetësisë. Ky themelues i paharuar i laboratorit të parë shqiptar, duhej pushkatuar!

Pandeli Nova, 59 vjeç. U lind në Opar, në një familje të pasur. Ekonomist. Zotëruar i disa gjuhëve të huaja. Deri në vitin 1944, u mor me tregti dhe njëkohësisht ndihmoi Frontin N.Ç. Pas luftës punoi në një shoqëri tregtare çeko-shqiptare.

Thoma Katundi, Më i "vjetri" në moshë, 64 vjeç! U lind në Katund të Korçës. Ish-"Vatran" në SHBA.

Mehmet Shkupi, 58 vjeç. U lind në Shkup dhe banoi në Tiranë. Ish-pronar me arsim të mesëm dhe me profesion nëpunës kaloriferi. Dyshohej si "agjent" i legatës franceze dhe se zhvillonte veprimtari terroriste. Pa prova konkrete për dënimin me vdekje pa gjyq.

Ali Qorraliu, 61 vjeç. U lind në Tiranë. Tiranasi i pasur. Jurist. Kreu studimet e larta në Kolegjin Juridik të Selanikut. Në kohën e luftës, ka përkrahur Ballin Kombëtar, ndaj u burgos nga regjimi komunist. U arrestua si "terrorist" dhe u pushkatua pa gjyq.

Fadil Dizdari, me origjinë nga Shkodra, u lind në Kavajë, Në kohën e Zogut kishte punuar si sekretar prefekturë. U arrestua dhe u pushkatua pa gjyq, i dyshuar si "terrorist", apo "armik i Pushtetit Popullor".

Hekuran Troka, 32 vjeç. U lind në Kuçovë dhe banoi në Tiranë, me profesion tregtar. Në listën e zezë është shënuar "tregtar i dyshimtë spekulant", "agjent i shërbimeve të huaja" dhe "terrorist". U pushkatua i dyshuar, pa gjyq.

Luka Rashkoviç, 51 vjeç. U lind në Mal të Zi. Ka ardhur në Shqipëri me familjen në kohën e mbretërisë. Gjatë kohëve të ndryshme u mor me transport udhëtarësh, në Shqipëri e Ballkan, jashtë çdo rryme politike. U arrestua dhe u pushkatua pa gjyq.

**Përgatiti:
Halil RAMA**

IN MEMORIAM

Mijëra familjarë, miq dhe të afërm e përcollën me të gjitha nderimet që meritonte birin e shquar të Zall Dardhës

LAMTUMIRE MIFTAR NDREU!!!

Halil RAMA

Para një viti, kur me bashkeautorin Sakip Cami, ishim në përgatitjet e fundit për monografinë "Bajram Ndreu i Zall Dardhës, bir i shquar i një familje të madhe", një tjetër pinjoll i këtij fisi emërdritur, ia shtoi vlerat kësaj monografie. Ishte pikërisht Miftar Ndreu, ky burrë fisnik që unë arrita t'i bëja foton që shoqëron këto pak radhë për të, atë ditë mbresëlënëse. Rrëfimet brilante të këtij simboli të mënçurisë dhe urtësisë dibrane janë ngulitur thellë në memorien time.

PARTIZAN NË BRIGADËN E V-TË SULMUESE

Njohja me Rexhep Dodën, ndikimi i kushuririt të tyre, Dali Ndreu dhe i Faikut dhe Esatit, i futën natyrshëm dhe me bindje në Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

U mobilizuan në luftë katër djem nga kjo derë, Selim Hysen Ndreu në Brigadën e IV-t Sulmuese, Bajram Ndreu e Miftar Ndreu në Brigadën e V-të Sulmuese, dhe Sulë Ndreu në Brigadën e IV-t Sulmuese. Sipas dëshmisë së Miftarit (sa qe gjallë): "Para se të rreshtohet në Brigadën e V-të Sulmuese, Bajrami ka qenë rreshtuar me forcat e çetës së Muharrem Bajraktarit. Ishte fundi i vitit 1943 dhe fillimi i vitit 1944, periudhë kjo, kur luftëtari nacionalist, Kolonel Muharrem Bajraktari luftonte i vetëm kundër pushtuesve gjermanë dhe nuk lejonte që Luma dhe Kukësi të pushtoheshin nga gjermanët. Në një nga këto luftime, Bajrami plagoset dhe kurohet në spitalin e Bicajt. Për një kohë të shkurtër, për të marrë veshen, kthehet në shtëpi dhe më pas rreshtohet në Brigadën e V-të Sulmuese"

SHTËPI KAFEHANE

Para një viti Miftari 90 vjeçar, na rrëfeu se si shtëpia e tyre ka qenë shtëpi kafehane. Shtëpitë kafehane kanë qenë të rralla në Dibër. Ato ishin veti e shtëpive të mëdha dhe të qena.

Shtëpia e Hysenit të Dardhës, dhe më pas e Mustafës dhe e Bajramit kanë qenë shtëpi kafehane.

Për ta sqaruar për lexuesin e gjërë, shtëpitë kafehane nuk ishin lokale me pagesë, sepse të tilla nuk ekzistonin në malësi.

Shtëpitë kafehane ishin shtëpi që lironin pjesë të kullës në dimër, bahçet në verë, që njerëzit e thjeshtë, rrugëtarët, vizitorët, miqtë të pushonin dhe të pinin një kafe



të mirë, një kafe Stambolli, që e dispononin vetëm shtëpi të tilla me emër.

Njerëz të ndryshëm që i zinte nata, që lodheshin nga rruga e gjatë për në Kukës dhe Mirditë, pushonin dhe pinin kafe pa para. Tingëllon keq kur thuhet pa para sot në kohën e ekonomisë së tregut, por bujaria dhe mikpritja tingëllonin më fort dhe më bukur në ato kohë të vështira, kur kafeja dhe ushqimi i boll-

shëm ishin luks.

KALVARI I MUNDIMSHËM I FAMILJES NË DIKTATURË. SI I SHPËTUAN INTERNIMIT TË DYTË?!

Pothuajse më shumë se gjysma e familjarëve të fisit Ndreu ishin internuar në Lushnjë, Lllakatund, Memaliaj etj. Por qeveria komuniste nuk mund të pajtohej as me gjysmën tjetër të mbetur akoma në fshat në gjend-

je të goditur dhe pothuajse të paralizuar. Frika se këta (Ndreajt) janë të tmershëm për tu riaktivizuar dhe për tu bërë përsëri familje e shquar siç kishin qenë ekzistonte tek pushtetarët vendorë, të cilët pas "rënies" së Ndreajve u kishte ardhur rradha për të drejtuar. Parimi i tyre ishte "shtyj, spiuno Ndreajt dhe familjet e tjera të qena dhe ngrihu në detyrë".

Ata kishin pikasur dhe

kishin vendosur që të largonin edhe Bajramin dhe Miftarin, dy ish partizanët dhe ish ushtarakët sepse ata ishin "dikushi" dhe nuk "përballoheshin" nga të paqenët që tashmë drejtonin.

Në mbledhjen e tre fshtrove Zall, Shllesh dhe Laçe kishte ardhur i deleguar, një instruktor i Komitetit të Partisë. Ai tha se Partia dhe Pushteti kishte vendosur që Bajram Ndreu të punonte larg fshatit, në Tartaj dhe Miftar Ndreu në Lashkizë.

Bashkëfshatarët bënë çudi me këtë propozim.

I pari që diskutoi dhe mbajti anën e Bajramit dhe të Miftarit ishte Brahim Kuta (Hoxha).

Nuk ka përse të largohen nga fshati, tha ai. Të qëndrojnë këtu. Ne kemi respekt dhe i duam ata.

Diskutuan edhe dy - tre bashkëfshatarë të tjerë, të cilët edhe ata folën me respekt për Bajramin dhe Miftarin. Pothuajse të gjithë kërkuan që të votojnë për qëndrimin e tyre në fshatin e lindjes, Zall Dardhë.

I deleguari i Partisë, një kuadër nga zona, që e njihje mirë familjen Ndreu, tha se nuk është nevoja për votim, pasi sipas tij dhe sipas parullës komuniste të asaj kohe, "Partia bën çfarë don populli", dhe meqenëse populli dëshiron që Bajrami dhe Miftari të qëndrojnë, atëherë ato do të qëndrojnë këtu midis jush.

Kështu Bajrami dhe kushuriri i tij, Miftari, i shpëtuan një internimi të dytë edhe më të keq, pasi do tu duhej që të punonin larg fshatit dhe në kushte shumë të vështira, të papërballeshme.

SI UA KTHEU KARTAT E FRONTIT JASHAR MENZELXHIU

Familjen e Mustafë Ndreut, në vitin 1952, pushteti i asaj kohe e shpalli "familje kulaku", ndonëse, dy djemtë e tij, Selimi dhe Bajrami qenë partizanë dhe kjo familje u bë Bazë e Luftës Nacionalçlirimtare! Ndonëse Selim Ndreu ishte dëshmorit i parë i Dardhës që kishte dedhur gjakun dhe në moshën 16-vjeçare kishte rënë në altarin e lirisë së atdheut!

Në memorien e Muharrem Ndreut, sot 75-vjeç ruhet e freskët ajo kohë e zymtë, kur po niste rrënimi i kësaj familje të madhe patriote.

"Kur i kishin thënë ish Sekretarit të Parë të Komitetit të PPSH-së, Dibër, Jashar Menzelxhiu se kishin shpallur "kulak" familjen e Mustafë Ndreut, ai i ish përgjigjur la-

ulemi ne tanimë në Zall Dardhë?! Kjo për faktin se, si gjatë Luftës NCCJ dhe në vitet e pasçlirimtit, dyert e konakut të Mustafë Ndreut ishin të çelura për këdo që vinte në Zall Dardhë në emër të interesave të dermanëve dhe për miqtë e udhëtarët e shumtë që i zinte nata në Dardhë".

Kishin kaluar shtatë vjet, - kujton Muharremi, kur Jashar Menzelxhiu kishte porositur Nebi Ndreun: I thuaj Bajramit të na dërgojë një letër! (Kjo me gjuhën e Dibërs...). Dhe të nesërmen në mëngjez, kur ish sekretari i parë po dilte nga shtëpia e tij për në punë, tek dera e shtëpisë ndeshet me Bajram Ndreun!

Pa u përshëndetur sipas zakonit, Jashari i thotë Bajramit: - Hë, a e solle letrën?!

Pas një jave, në Dardhë vjen

Banush Goxhaj - ish Kryetar i DPB të rrethit Dibër për t'i sjellë kartat e Frontit familjes së Mustafë Ndreut, çka nënkuptonte se me urdhër të partisë, ajo nuk do të ishte më familje "kulaku". Por Mustafa, me urtësinë dhe mençurinë e rrallë që e karakterizonte, nuk e pranonte këtë akt formalisht, ndaj dhe këmbënguli që dhënia e kartave të frontit të bëhej në një mbledhje të zgjeruar të popullit të Dardhës.

vPor edhe pse ky akt nënkuptonte çuarjen në vend të dimitit të kësaj familje, Muharremi kujton persekutimin e gjatë 40-vjeçar nga ish sigurimsat e regjimit ogurruz, kur ua mbajtën çekicën mbrapa kokës të gjithë djemve të familjes, duke ua kujtuar në vijimësi nofën "kulak". Më shumë se kushdo, pasojat e këtij regjimi, ndër më

gjakatarët që ka njohur historia e njerëzimit, i vuajti Bajram Ndreu, por edhe kushëri i tij, Miftari, i njohur për mençurinë dhe vizionin e tij perëndimor për jetën dhe atdashedashurinë e zjarrtë. Dhe megjithë vështirësitë e shumta gjatë sistemit diktatorial, ai krijoi një familje të mrekullueshme, e nderuar dhe e reapsktuar jo vetëm në Dardhë, por në krejt Dibërën. dhe tani së fundi në Paskuqan, Kamëz, Tiranë e gjetkë. Ndarja e tij nga jeta para pak ditësh më shkaktoi vërtetë dhimbje të thella, ashtu si edhe mijëra familjarëve, miqve dhe të afërmeve të tij, që e përcollën me të gjitha nderimet që meritonte birin e shquar të Zall Dardhës.

Parajsa qoftë vendbanimi i tij i përjetshëm!

IN MEMORIAM

Vepra e Profesor Sokolit përfshin një diapazon te gjerë në një periudhë kohe prej 16 shekujsh

Tetë vjet pa Ramadan Sokolin, studiuesin që shqipëroi shekujt

Nga Ilir Seci

Më 10 mars mbushen tetë vjet që kur u nda nga jeta kollosi i etnomuzikologjisë shqiptare, Prof. Ramadan Sokoli. Me emrin e tij është e lidhur historia e muzikologjisë shqiptare, vepra e tij shënon fillimin e kësaj discipline shkencore në Shqipëri nga ky studiues kemi studimet e para që shtruan linjat nga nisi pastaj puna për studimet shqiptare. Profesor Ramadan Sokoli vjen prej një rësi nga nga familjet me të njohura të tradites dhe qytetarisë shkodrane e shqiptare, atë të Sokolëve që gëzon një emër të shquar në historinë tonë kombëtare, kujtojmë figurën e Hodo Pashë Sokolit, mbrojtësit legjendar të Hotit e Grudës, trojeve shqiptare në Mal të Zi.

Ramadan i lind në Shkodër me 1920, pas shkollimit në vendlindje vazhdon studimet e larta në Padova Itali, Universitetin e famshëm ku studion për muzikë, moment me rëndësi pse profilizohet e ardhmja e tij. Por rrjedhat e fatit i sjellin ndryshime të mëdha në rrugën e tij si studiues. Lufta e Dytë Botërore nuk kish si të linte jashtë familjen e Sokolëve. Dy vëllezërit e tij ishin pjesëmarrës aktivë në radhët e forcave nacionaliste, Ibrahim Sokoli dhe Hodo Sokoli, njihen si legalistë e nacionalistë, që i vunë pushkën pushtuesve italianë e gjermanë. Me vendosjen e regjimit komunist të tre vëllezërit, Ibrahim, Hodoja, Ramadan, arrestohen dhe dënohen me burgim të gjatë duke njohur tortura e vuajtje të rënda. Ramadan arrestohet dhe dënohet pa asnjë akuzë vetëm si vëllai i Ibrahimit e Hodosit?

Miku i ngushtë i Ramadanit, poeti dhe studiuesi të ardhme të shkëlqyer, Qemal Draçini, vdes në rrethana të dyshimta në burg, versioni zyrtar ishte "vetëvrasje me helmim!". Pothuajse të gjithë miqtë e tij janë burgosur kësokohe dhe do të ishte miku i tij i vjetër Lazhar Siliqi që pas dhjetë vjetësh do e nxirrte nga gulagët e Hoxhës duke shfrytëzuar nevojën e regjimit për njerëz të kualifikuar në fushën e studimeve muzikore.

Por edhe kështu zinxhiri i vuajtjeve të Ramadan Sokolit nuk mbaronte, do të studionte, me kushte, do shkruante me kushte, do krijonte por pa emër, si anonim pasi "Partia e dinte kush ishte!"... Falë punës së tij Ramadan Sokoli bëhet themelue-



si i muzikologjisë shqiptare nëpërmjet veprave "Folklori muzikor shqiptar (Morfologjia)", "Veglat muzikore të popullit shqiptar", "Vallet dhe muzika e të parëve tanë", "Figura të ndritura", "Gjurmime folklorike", "Këngët patriotike", etj. Përveç këtyre vëllimeve ka botuar një numër të madh artikujsh studimorë rreth degëve të ndryshme etnokulturore, gjithashtu ka mbajtur shumë ligjërata radiofonike krahas dokumentarëve televizivë. Ka drejtuar ekspeditat e para etnomuzikologjike në Shqipëri. Ndihej në të vyer ka dhënë edhe si studiues folklorit letrar sidomos rreth ninullave, këngëve të shpōtisë, këngëve popullore per dashurisë, vajtimeve, gjëmave dhe elegjive mortore, rreth dramaturgjisë popullore. Lëmia më e rëndësishme e veprimtarisë së Ramadan Sokolit mbetet ajo e etnokulturës shqiptare që nga lashtësia ilire e te ajo arbërore deri në kohët më të afërme.

Prof. Sokoli ka bërë një punë të vyer në këtë lëmi

duke shkundur pluhurin e harresës nga epoka të tëra, studime si: "Figura e Skëndërbëut në muzikë" janë të rralla, po ashtu ky studiues ka zbuluar më shumë se 40 personalitete shqiptare nga fushat e dijes e artit duke argumentuar shqiptarësinë e tyre. Hulumtimet e Ramadan Sokolit janë shtigje të çelura për të pari dhe shquhen për thellësinë dhe gjerësimin e njohurive si dhe seriozitetin e gjykimit shkencor. Për shumë kohë ka punuar si arsimtar duke hartuar programe e tekste mësimore si dhe duke kompozuar repertor të pasur për edukimin e gjeneratës së re të muziktarëve. Thëksojmë me këtë rast se brezi i parë i flautistëve shqiptarë janë nxënësit të Ramadan Sokolit. Në fushën e krijimtarisë shquhet si kompozitor, është autor i shumë veprave vokale e instrumentale, muzikës së dhomës, këngëve, etj.

SHQIPËRIMI I SHEKUJVE

"Dy fjalë: "Njih vetveten!".

Vetëm këto dy fjalë kuptimplota i kish gdhendur dikush në ballin e hyrjes së një tempulli famëm madh të lashtësisë.

Njih vetveten! Kjo porosi e mençur mbetet me vlera të përhershme jo vetëm për njerëzit në veçanti, por edhe për popujt në përgjithësi, sepse, siç thoshte poeti rilindas, Naim Frashëri, "Ç'vleftë t'i verë vehtes një komb, atë i venë dhe të huajtë!".

- Këto janë fjalët me të cilat e fillon këtë vepër Profesor Ramadan Sokoli duke na sjellë një studim të rrallë në fushën e kulturës sonë kombëtare.

Vepra e Profesor Sokolit përfshin një diapazon te gjerë në një periudhë kohe prej 16 shekujsh pikërisht atë periudhë më të errët të historisë sonë kombëtare kohën nga rënia e Perandorisë Romake deri në kohën e pas Pavarësisë, periudhë kur kombi ynë kalon nëpër pushtime e shkatërrime duke plotësuar një boshllëk në kushtet e mungesës së shkrimit e dokumentimit historik.

Puna e rilindasve përg-

jithësisht është e evidentuar, por ishin plot figura "shqipe larg folesël" që kërkonin të njiheshin më mirë, të përfshiheshin në kulturën shqiptare për t'u bërë pjesë e saj si trashëgimi. Me zbulimin e shumë vlerave të së kaluarës, vepra e Ramadan Sokolit plotëson në mënyrë të ndjeshme njohuritë mbi qytetërimin e lashtë të kombit tonë. Profesi mori zellin e arkeologut shpluhuros historinë, nxjerr copat nga terri, i bashkon e ndërton kapitujt e historisë sonë kombëtare pikërisht në kohën kur mungon më tepër, shekujt e errët që tërë bota i quan "Dark Age".

DY FJALË PËR FUND...

Ramadan Sokoli, si muzikolog, është personalitet i njohur edhe jashtë vendit ku vepra e tij studimore gjeti vlerësimin e merituar, vite të tëra pune që në Shqipëri kur nuk u shpërblyen e gjetën jehonën jashtë atdheut!

Duheshin pritur vitet '90 që Ramadan Sokoli t'iu përgjigjej ftesave të shumta për të marrë pjesë si lektor në Universitetet e ndryshme të Europës apo në konferencat e simpoziumet ndërkombëtare ku ai pritej me respektin që i takonte. Prof.Sokoli ka prezantuar punime e leksione në Gjermani, Zvicër, Itali, Greqi Turqi, Sllovakia, etj. Vetëm pas '90 studentët e shkollave të muzikës e të Institutit të Arteve mundën të mësojnë se autori i disa prej pjesëve instrumentale, këngëve popullore, valleve nuk ishte një anonim, por ishte kompozitori Ramadan Sokoli.

Në vitin 1995 Akademia e Shkencave të Shqipërisë i dha zyrtarisht titullin "Profesor" duke e zgjedhur anëtar të kësaj Akademie. Por ky "rehabilitim" fatkeqësisht nuk zgjati shumë, në vitin 1999 rikthehet në krye të Akademisë së Shkencave brezi i vjetër dhe Akademia në zgjedhjet e fundit nuk e rizgjedh anëtar të saj! Në vitin 2002 Presidenti Alfred Moisiu e nderon me titullin e lartë "Mjeshtër i Madh i Punës" duke nderuar në radhë të parë shoqërinë shqiptare, e cila duhet të ndjehet krenare me brij si Ramadan Sokoli. Emri dhe vepra e Prof. Ramadan Sokolit është përfshirë në disa enciklopedi të huaja edhe në Enciklopedinë e Personaliteteve të Shquara të Shekullit të XX, përgatitur nga Qendra Ndërkombëtare e Jetëshkrimeve në Cambridge, Angli.

STUDIMI

Në fillim të shek. XVIII-të, Kallmeti u shpall bajrak më vete, u shkëput prej Zadrimës, por mbeti me lidhje të ngushta tradicionale

Zadrimea (Tejdrina) e vetëqeverisur

Nga Xhemal MEÇI*

(vijon nga Nr. i kaluar)

FAMULLITË -NJËSITË BAZË TË VETË DREJTIMIT TË ZADRIMËS (1503 - 1759)

Këto njësi famullitare bashkë me famullitarin kishin rolin (detyrën) e tyre jo vetëm fetare, por edhe atë shoqërore e politike, siç kishte në një shkallë më të lartë edhe vet ipeshkvi i Sapës për Zadrimën. Kështu, në krye të famullisë shquhej famullitari. Famullitarët bashkë me meshtarët e tjerë e kishin traditë "të mblidhen tri herë në vjet të shtëpia e ipeshkvit, d.m.th. pasë ditës së dytë të pashkëve, pas festës së të gjithë shejtëve dhe mbas epifanisë dhe aty mbahen konferenca në gjuhën epirote (shqipe)... për të mirën e besimtarëve të krishtenë." (Fr. Bardhi, relac. II/f. 93). Po të shtojmë edhe kuvendin e përvitshëm ipeshkvor (sinodin) bëhen 4 kuvende të diocezit dhe ipeshkvisë ku shkoqiteshin çështje besimi, por edhe çështje "për të mirën e besimtarëve" të krishtenë. Kjo traditë e karakterit fetar krijonte mundësi për tubime pa probleme me autoritetit turke. Në këto tubime të zakonshme, u jepej mundësia famullitarëve dhe vetë ipeshkvi që të ishin të përgaditur dhe unik në qëndrimet e tyre për interesat e të krishterëve në veçanti, si edhe të Zadrimës në tërësi, duke i harmonizuar me interesat e komunitetit tjetër, të besimit mysliman. Nga mesi i shek. XVII del se numri i myslimanëve kishte arritur në 1/7 e popullsisë së Zadrimës. Raport të saktë nuk ka, sepse Fr. Bardhi, diku shprehet se "Besimtarët (të krishterët) Zadrimorë... (ishin) të përzium me shumë turq" (myslimanë), në Dajç e "ndër rrethe (rrethina) dhe katunde të kësaj famullie janë shumë shtëpi të turqve" (myslimanëve); kurse pak rreshta prej aty thekson numrin e të krishterëve në mijëra (14.000), për myslimanët shprehet se "faleminderës Zotit, numri i turqve është shumë më i pakët." (Po aty.) Megjithatë ai numër "i pakët" ishte gjithnjë në rritje, siç shihet në Mjedën e Epër, me një mesxhidi (faltore pa minare), ku kryenin ritet fetare myslimanët, aty. "Në atë vend, - pohon vetë Fr. Bardhi, - shumë të krishtenë e kanë zakon të bëhen turq, veçanërisht ditën e bajramit (Bajramit të Madh, pas Ramazanit, agjërimit". Fr. Bardhi, Relac. II, fq. 217).

Sado që në relacione përdorej një retorikë e stil i rëndë



në drejtim të myslimanëve vendas (të cilët shiheshin me dyshim për ndërrimin e besimit) megjithatë nuk mungonin faktet, ku në përgjithësi shprehet mirëkuptim e respekti i ndërsjellët në mes të dy komuniteteve të Zadrimës: të krishterë e myslimanë. Le të shkëpusim disa fakte të tilla të vetë relatorët. Marin Bici për xhabinë administrativin e taksave, Mustafë Çelebia (mysliman zadrimor) shënon se "Asht njeri me cilësi të mira e njerëzore, veprat e mira të cilat ata të krishtenë nuk pushonin tue i lavdue." (M. Bici, Relac. I, fq. 109, arqipe-shkvi i Tivarit, 1611).

Fr. Bardhi: "Ju lajmoj për ardhjen time... në kishën time të Sapës, ku qeshë pritë me shumë përkushti dhe me dashuni të përzemërt prej këtyre popujve shqiptarë, bile edhe turqit (myslimanët), (që të gjithë Zadrimorët) më kanë pritur madhnisht." (Fr. Bardhi, Relac. II, Sapë, 7 shtator 1636, f. 19).

Fra Kerubini, nënprefekti i misioneve italiane në Shqipëri: "Kush don me qenë i krishtenë i mirë, mund të jetë shumë mirë, as nuk i pengohet, mjaft veç që të paguajë haraçin e time dhe të dhetën e tyne, e pastaj të agjinojnë, të shkjojnë nëpër kishët, të rrëfehen e të kungohen si të duen..." (Relac. II/fq. 109), 27 mars 1638.

Pra, siç shihet qoftë edhe vetëm në këto pohime të prelatëve kishtar, në relacionet e tyre dërguar Vatikanit, komuniteti mysliman vendas i Zadrimës ishte në lidhje të mira me komunitetin e krishterë. Interesat e ngushta vendore krahinore brenda një statusi të përbashkët të vetqeverisjes, më shumë i bashkonte se i ndante për çështje besimesh të ndryshme.

Kështu Zadrimea është një shembull tjetër, ku pasqyrohet jo vetëm bashkëjetesa e qetë midis dy komuniteteve fetare, por edhe me një bashkëqeverisje të harmonishme. Ndarja e diocezit

harmoni në mes të dy komuniteteve fetare: të krishterë e myslimanë. Kjo traditë e mirë e tyre në Zadrimë do të shprehej në vazhdimësi, si edhe dy shekuj e gjysëm më pas prej vëllezërve të shquar: dom Ndre Mjeda dhe dom Lazër Mjeda e tjerë.

ORGANET DREJTUESE TË ZADRIMËS KUVENDI KRAHINOR I I ZADRIMËS

Kuvendi mbarëkrahinor ishte Organi më i lartë i vetqeverisjes së Zadrimës autonome. Kuvendi tradicional mblidhej rregullisht një herë në vit, Ditën e Shëngjergjit, më 6 maj. Vendi tradicional i tubimit të Kuvendit mbarëkrahinor ishte Lugu i Shmarkut, një rrafshinë në VL të shën Mërisë së Dejës. (Sot ai lug është i populluem me shtëpi të ish-punëtorëve të Hidrocentralit të Vadejës). Kuvendi i 6 majit përbëhej prej 100 pleqve të katundeve, ku hynin edhe 8 pleq të famullive, 25 lajmëtarët e fshatrave, si edhe kryfamiliarët, "shpi e zotshpije". Shtëpitë e vogla përfaqësoheshin më tepër prej kreut të fisit a të parit të vëllazërisë.

Fjala ishte se në Kuvendin e Zadrimës mblidheshin 1000 burra, por Duke marrë parasysh shtëpitë e vogla, që një pjesë e mirë e tyre përfaqësoheshin me kërkesën e tyre prej kreut të fisit a të parit të vëllazërisë, numri i burrave në Kuvend nuk i kalonte pesëqind. Tagri i tyre ishte për mbarë Zadrimën.

DETYRAT E KUVENDIT

Kuvendi kishte për detyrë të shqyrtonte dhe të vendoste për këto çështje:

1. Propozimi për xhabinë (administrativin civil të krahinës e taksave) dhe kadinë (gjyqtarin);

2. Mbrojtja e tagrit të vetqeverisjes, duke shoshtur ankesat për t'ia dërguar Sulltanit për dhunën që mund t'u bëhej prej sanxhakbejerëve etj.

3. Caktimi i pleqve që do të bënin ankesat në Stamboll bashkë me shpenzime edhe për ta;

4. Puna gjatë vitit e çdo katundi për mirëmbajtjen e 30 urave;

5. Masat për zgjidhjen e ndonjë mosmarrëveshjeje mes katundeve etj.

Fr. Bardhi i përmbledh kështu detyrat themelore të Kuvendit mbarëzadrimorët: "në mblidhje (Kuvend) shoshiten gjithmonë interesat e turqve (myslimanëve) dhe të krishtenëve Zadrimorë." (Fr. Bardhi, 1641).

IPESHKVI I SAPËS NË KUVEND, STATUSI

Për statusin e Kuvendit dhe të kryetarit të tij, të ipeshkëvit, vetë Fr. Bardhi thotë:

1. "Kryetari i kësaj mblidhjeje (Kuvendit të Zadrimës) asht ipeshkvi" (i Sapës); (Fr. Bardhi, Relacione II, fq. 205);

2. Ipeshkëvi i Sapës që të kryesoi Kuvendin "duhet të jetë origjine dhe i lindur Zadrimor." (Fr. Bardhi, po aty);

3. Kuvendi e ngarkon me përgjegjësi kryetarin e vet, kur mungon në tubim. "Kuvendi... flet keq për atë që nuk asht i pranishëm" në atë tubim. (Fr. Bardhi, po aty, f. 207)

4. Ipeshkëvi duhet t'i jap drejtim Kuvendit për zgjidhjen e çështjeve që kërkojnë; prandaj "duhet veprue sa ma me shkathtësi". (Po aty).

Për raste mbrojtjeje, kur armiku prek kufijtë e Zadrimës, Kuvendi i Besëlidhjes (për luftë) tubohej afër vendit, ku po bëheshin përgatitjet për mbrojtje dhe vendosej se si do të veprohej, siç ishte rasti i vitit 1610. "Në kaqë Zadrimorët, tue pa se anmiqtë po donin t'u binin, banë Kuvend para se të ndizej zjarri e para se turqit (Sanxhakbeu i Shkodrës) të fillonin me i damtue, vendosën të dërgonin dhurata për ta qetësue Sanxhakbeun... Si e panë se Sanxhakbeu nuk po tërhiqej, "u bashkuar nën komandën e Saferit, prefektit (zëvendësuesit të xhabisë) dhe



STUDIMI

për më se dy shekuj



u përlëshën me armiqtë e tyre. (M. Bici, Relac. I/125)

Mbas kësaj lufte, që përfundoi me humbje, qendra administrative e Zadrimeës u zhvendos në Dajç. Dajçi është mbi kodra, strategjik dhe mesvendi për Zadrimeën.

Nga përsëkrimi që bën relatori M. Bici, del se mekanizmi i drejtimit të Zadrimeës vepron te mjaft mirë. Duke e parë rrezikun e sulmit grabitqar të armikut, u shpërndan lajmëtarët nëpër katunde për tubim lufte, "burr për shpi". Burrat u mblodhën të armatosur. Para se të fillonin luftën, bën Kuvend dhe morën vendim që, të bënin përpjekje për ta zbutur e qetësuar armikun me dhurata dhe shprehje fëmijësie të mirë. Në rast të kundërt, do t'i përgjigjeshin me luftë si u përgjigjen.

Marrja e komandës së luftës prej Saferit (zëvendësit të xhabisë) nuk ishte e rastit, por një traditë. Bashkimi me forcat e veta edhe të Ferat Kotus aga, të Gjadrit, tregon se myslimanët e Zadrimeës ishin të bashkuar me të krishterët kundër armikut të përbashkët të Zadrimeës, sado që shumica e tyre myslimanë. Pra, interesat e lidhjet vendore në mes të dy komuniteteve (myslimanë e të krishterë) të Zadrimeës ishin më të forta se dallimet në besimet fetare.

SI VETËQEVERISEJ?

Në marrëveshjen e bërë me Sulltanin (Oborin Perandorak), që më 1523 për Zadrimeën, është vendosur që kadia, si edhe xhabia, të propozoheshin prej Zadrimeorëve. Të drejtën e propozimit e kishte Kuvendi, ku shumicën e kishin të krishterët. Për ekuilibër politik e shoqëror, i propozuar duhet të ishte një Zadrimer mysliman. Një kadi që do të gjykonte simbas Sheriatit (të drejtën fetare islame) duhet të ishte mysliman dhe me një përgatitje të mjaftueshme teologjike e juridike dhe zotërimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit, për ekuilibër në gjykim duke res-

pektuar traditën.

Xhabia, edhe ky Zadrimer mysliman, nuk ishte thjeshtë një mbledhës taksash, se sa një administrator i tributit që i detyroheshin Stambollit. Njëkohësisht, ai kishte edhe prefektin (zëvendësin për çështjet e mbrojtjes, siç ishte Saferi, i cili drejtoi luftimet më 1610 dhe rezistoi me guxim e trimëri të rrallë derisa u tërhoq shumica.) Xhabia kishte të drejtën për marrëveshje me fqinjët për marrëdhënie të mira me Zadrimeën dhe vetë atë. Si i tillë, xhabia ishte një figurë e rëndësishme politike e shoqërore për Zadrimeën; prandaj ai duhej të gëzonte besimin e Zadrimeorëve. Kuptohet, besimin e të krishterëve të Zadrimeës, duke u propozuar prej tyre në Kuvend.

Për të ruajtur një ekuilibër mes komuniteteve dhe për t'ua kufizuar pushtetin e këtyre dy figurave, kadia e xhabia, nuk mund të qeverisnin më shumë se 18 muaj.

Fra Kerubino thekson se Zadrime ka një kadi, që të baj gjyq dhe një xhabi të zgjedhën prej tyre dhe jo tjetër. (Fra Kerubino, II/1965). Fr. Bardhi, saktëson më qartë për zgjedhjen dhe qëndrimin në qeverisje; Kadiu... i cili çdo 18 muaj ndërrohet prej turkut të madh (Sulltanit, si edhe Xhabisë)... "që e emnon (Sulltani) vjet për vjet, ma të shumtën atë që duan Zadrimerët". (Fr. Bardhi, ... II/fq. 205 e 213).


Një nga masat e zbatimit të marrëveshjes që të "Qeveriset krahina e Zadrimeës si një republikë" është caktimi i kadiës vetëm për Zadrimeën, një nga të pesë kadilerët që ka krejt Sanxhaku i Dukagjinit (Pejë, Gjakovë, Alltun - Ili, Plavë, Zadrime, Lezhë.) Fare lehtë mund të kishte për kadi kadinë e Lezhës, si krahinë afër Lezhës dhe e të njëjtit sanxhak, sanxhakut të Dukagjinit. Përkundrazi, ka kadinë e vet, që banon në Zadrime, për më tepër -një vendas që të mund ta njihnin dhe me të drejtën e propozimit të Sulltanit. (Skënder Rizaj,

Kosovë gjatë shek. XV-XVII. Tiranë, 1987, fq. 61).

PLEQSITË DHE STATUSI I TYRE

Duke u bazuar te relatorët e ipeshkëve së Sapës, si edhe në studimin për zonën e Kallmetit (të M. Prendushit), botimin Zadrime (të P. Gjonit), Dajçi (i G. Milotit), bashkë me hulumtimetprej meje direkt në terren këto vitet e fundit, arrihet të dallohet mirë institucioni i plakut dhe roli i tij kryesor në vetqeverisjen e Zadrimeës. Ja disa copëza, ku del jo vetëm plakut si institucion krahinor, famullie, por edhe fshati: "Shpeshherë në vjet mblidhen të gjithë shpi për shpi dhe veçanërisht pleqtë dhe të parët e saj (të Zadrimeës)... për të meremetue urat, përndryshe... krenëve do t'u shkonte koka." (Fr. Bardhi, Relacion, 1641, fq. 205); "deri sa pleqtë e Zadrimeës, si edhe ipeshkëvi vet të shkojnë në Stamboll..." (Po aty, fq. 209) "ipeshkëvi asht i detyruem me shkue (te Mehmet Beu përtej Drinit) bashkë me pleqtë e vet të Zadrimeës." (Po aty, fq. 217); "...simbas marrëveshjes së thanun, qenë të knaqun jo vetëm kleri, por edhe pleqtë e vendit (të fshatrave)... prandaj për secilin famulli të ngarkohen dy pleq (që janë) në frigë të Zotit..." (Gj. Bardhi, relacion, 1643, fq. 283). >>>>

Këto pohime të paramesit të shek. XVII janë dëshmi që ndihmojnë në përcaktimin e kuadrit të institucionit të plakut, si një traditë në organizimin shoqëror e politik të fshatit, visit, krahinës e më gjërë. Kështu krahina e Zadrimeës ka "të parët" (parinë, krenët) e vet. Tradita tregon se pleqtë, "të parët" e Zadrimeës, ishin plak për famulli dhe bashkë me një prej Kallmeti, bësheshin, kështu, "9 pleqtë e Zadrimeës", "9 të parët" e saj. Këta pleq, që përbënin krenët e Zadrimeës, mblidheshin sa herë ishte e nevojshme për të shqyrtuar e vendosë për interesat në shkallë krahinore, Zadrime. Njëri prej këtyre 9 pleqtë të parë do të ishte plak i parë i Zadrimeës, simbas radhës së famullive në Diçezë. Kjo traditë është ruajtur në shekuj në Pukë, Mirditë etj. Në Pukë çdo bajrak (njësi drejtimit shoqëror e ushtarak) kishte të parë bajrakun vojvodën (kreun a plak bajrakun). Në Mirditë, plak bajrakun. Në Pukë e Mirditë plakun i parë, kreu i parë (plak bajrakun, vojvodë), do të ishte simbas radhës së bajrakëve. Në Pukë - fis e bajrak i parë, Kabashi. Në Mirditë, Oroshi. Në çdo tu-



bim e ndeje të fiseve të Shtatë Bajrakët e Pukës do të ishte vojvoda i Kabashit, Lluka. Ndër bajraktarë, Furriku. Në Mirditë, plak bajrakun i Oroshit, shtëpia e Dodë Gegës. Zadrime, si krahinë kufi me Mirditë e Pukë dhe me lidhje demografike me to, ka në përgjithësi po atë organizim. Pra, herët printe plakun i Mjedës. Kur Dajçi u bë qendra drejtuese e Zadrimeës me kadi e xhabi, i parë ishte plakun i famullisë së Dajçit, i shtëpisë së Zezajve. Në mungesë të tij, plakun i Milotit, Gegë Milotit.

Në fillim të shek. XX, i Sollakut, Shtjefën Sollaku, i Blinishtit, (Zezajt e Sollakët dihen për Kabash).

Me vendosjen e institucionit të bajrakut, fillimi i shek. XVIII, kur Kallmeti u shpall bajrak me vete, u shkëput prej Zadrimeës, por me lidhje të ngushta tradicionale, sa Kallmetasit e qanin Zadrimeën: "Zadrime jonë", sado që Zadrime i quante: "Malacakë", sepse fshatrat lindore të Zadrimeës prej Nënshati, Krajni, Fishte e Troshani, si edhe Kallmeti, Raboshati e Mërqia, së bashku me Malësinë e Lezhës, quheshin: "Ana Malit", prej nga u mbet në Zadrime emni "Malacakë". (Mikel Prendushi, Vështrim etnografik mbi zonën e Kallmetit. Etnografia Shqiptare, Tiranë, II/1963.)

Pleqtë e fshatrave ishin simbas lagjeve (mahallëve), që është bërë zakon të quhen pleq "fisesh". Çdo fis kishte

plakun e vet. Në fshatrat fushore përbërja fisnore është e ndryshme. Brenda një fshati jetojnë disa fise pa lidhje farefisnore. Prej fiseve më të mëdha dalin edhe pleqtë e këtyre fiseve. Fiset e vogla përfaqësohen prej fiseve më të mëdha fqinjë, kur është e nevojshme për tubime të pleqëve të fshatrave të mbarë Zadrimeës.

Brenda fshatit edhe fiset e vogla kanë prijësin e vet, por jo me tager plakun, sepse pleqtë janë një numër i caktuar tradicional. Kur ndonjë prej fiseve të vogla rritet në shtëpi apo arrin në një familje të madhe patriarkale, si fisi i Milotit në Dajç, atëherë ai ka plakun e vet. Ky plak, si në rastin e fisit të Milotit apo të Sollakut në Blinisht, jo vetëm që hynë ndër pleqtë e fshatit të vet, por fiton rëndësi edhe në pleqtë e fshatrave të Zadrimeës, deri te pleqtë e famullisë dhe të parët, krenët e Zadrimeës. si përfundim paraqet rëndësi për historinë për një autonomi të gjërë si adrima, një krahinë jlane

***Studjes - Mjeshtëri i Madh**



KULTURE

Jani Lufi boton në Rusi romanin biografiko - historik kushtuar jetës së Heroit të Popullit Petrit Dume

Një roman i gjeneralit për gjeneralin

NOVRUZ ZEJNATI

Pas një karriere sa të çuditëshme aq edhe të suksesshme, Jani Lufi "Partizani shqiptar gjeneral i ushtrisë sovjetike" (siç e ka titulluar vetë librin e tij të parë me kujtime, përkthyer edhe në shqip), tashti në pension, qysh nga Krasnodari ku jeton, pasi ka botuar monografitë për jetën e Pirros së Epirit dhe Skënderbeut, shkruan një libër për jetën dhe veprën e ish eprorit të tij, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë tonë, të cilin marrja e sistemit diktatorial e pushkatoi në Dhjetor të vitit 1975.

Libri titullohet "Biri i madh i popullit shqiptar" dhe synon t'i japë lexuesit rus, portretin e Petrit Dumes, këtij strategu të shquar, si pjesë e historisë tonë të lavdishme luftarake, por dhe e absurditeteve nga ajo kaloi si rezultat i politikës që u ndoq në Shqipëri, ku u kopjuan dhe përsëritën goditjet e pa drejta ndaj kuadrove kryesore dhe jo vetëm në ushtri.

Autori, nuk e ka kufizuar përsh-



krimin e tij vetëm në vlerat e protagonistit, por ai e ka trajtuar atë të pa

shkëputur nga gjithë zhvillimet sociale, ekonomike, politike dhe ideologjike që ngjanë, si gjatë luftës për çlirim, ashtu edhe gjatë përpjekjeve për fuqizimin dhe modernizimin e aftësisë mbrojtëse të vendit. Dumja ishte pjesë e atij realiteti dhe njeri i angazhuar në fatet e Atdeut, nisur nga idealet e larta në të cilat besonte ai dhe familja e tij e cila nxorri nga gjiri i saj shumë bij e bija partizanë, gjersa vëllaj i tij Bakiu, ra dëshmor.

Përfshirja e Petrit Dumes në lëvizjen antifashiste, marrja përsipër e detyrave të rëndësishme si ajo e komandantit të çetës dhe batalionit partizan "Hakmarrja" në Kolonjë, deri komandantit i Brigadës së XVIII - të Sulmuese dhe pas çlirimit emërimi si komandant Divizioni në Gjirokastrë dhe Korçë, përballimi i agresionit në provokacionet e Gushtit 1949, arsimimi i tij në akademitë e ish Bashkimit Sovjetik "Frunze" dhe "Voroshilov", gjendja e ushtrisë shqiptare pas luftës së Dytë Botërore, ndihma e B.S. për ushtrinë,

puna prej organizatori dhe reformatori e Petrit Dumes në detyrën e shefit të Drejtorisë Operative dhe pastaj për një kohë të gjatë, si shef i Shtatmadhorisë, ngjarjet pas plenumeve për ushtrinë pas vitit 1974, ku ish gjeneralët, deri dje heronj, u kryqëzuan si puçistë dhe tradhtarë, gjë që i dërgoi në plumb dhe burgime të gjata, janë kapitujt më të rëndësishëm të këtij libri. Jetën dhe veprën e Petrit Dumes, cilësitë e tij njerëzore dhe talenti i tij i rrallë si organizator ushtarak, guximi dhe nisitva që e karakterizonin, vendosmëria dhe këmbëngulja në zbatimin e detyrave, rritja e aftësive profesionale të kuadrove, skrupuloziteti në kryerjen e detyrave më terren të vështirë, shembulli i tij personal, takti i lartë pedagogjik me vartësit dhe nxitja e debatit që ia lartësuan emrin në të gjithë efektivat e ushtrisë, Jani Lufi që e ka njohur personalisht atë, i vë në dukje këto vlera mjaft thjeshtë dhe qarta. Këtë stil ai ka përdorur në të gjithë librat e tij, ku qysh në fillim bie në sy, dashuria për Shqipërinë dhe popullin shqiptar.

Në këtë roman biografiko - historiko, jepen edhe aspekte mjaft domethënëse të karakterit të drejtë, të fortë e të pae-pur të këtij drejtuesi, kujtimi i të cilit do rrojë gjatë në mendjet e kujtdo që punoi apo e njohu atë.

Në një farë kuptimi ai mbeti përfaqësuesi më dinjitoz i fatit të atyre kuadrove madhorë që i shërbyen me aq besnikëri atdeut të tyre dhe e pësuat nga etja për sundim e komandantit të tyre megaloman.

Ve gjithë jeta e Petrit Dumes dhe ajo e gruas, vajzave, motrave dhe vëllezërve të tij është dëshmi e pakundërshtueshme e propësie dhe dëmeve të mëdha që në emër të "luftës së klasave" dhe "diktaturës së proletariatit" iu bënë vetë Shqipërisë, popullit tonë dhe ushtrisë së tij.

Në libër jepen fakte sesi ushtria jonë, nga alucionacionet e E. Hoxhës, duke adaptuar heqjen e gradave, vendosjen e Partisë në komandë, politikën në plan të parë, dhënien llogari para masave, kontrollin punëtor - ushtar, kryerjen e shërbimit ushtarak të detyrueshëm pranë vend banimeve, tepirimin në fortifikim, resurse njerëzore, shpërndarjen e saj nëpër pika hapjeje, marrjen me ekonomi ndihmëse, me dele, lopë e derra, etj. në vend që të forcohej, nisi të çthuret e dobësohej, duke u shndërruar në një instrument formal, gjersa likuidimi i kuadrove drejtuese me përvojë dhe eksperiencë dhe dyshimi mbi oficerët në përgjithësi e shkatërroi përfundimisht.

Të gëzon fakti që Jani Lufi në Rusi, edhe pse i shtyrë në moshë, veç shkriemeve dhe botimeve të tij për Shqipërinë, me ndihmën e pakursyer edhe të profesoreshës Marina Skorik, ka botuar në rusisht edhe dy romane të mijat, titulluar "Lotët e zambakut" dhe "Pushkatimi", ku flitet për të vërtetat e hidhura dhe fatet e oficerëve që studiuan në atë vend dhe që u përndoqën, duke u akuzuar si të agentë dhe të pabesueshëm ata dhe gratë e tyre, gjë që çoi në drama të vërteta, në prishjen e sa e sa familjeve.

DR. NOVRUZ ZEJNATI - KOLONELI QE SHKRUAN PER TE GJITHE

SHPENDI TOPOLLAJ

Kush nuk e njeh Novruz Zejnatin. Ushtarak i lindur, doktor i shkencave, kolonel Zejnati ka qenë komandant i Brigadës së Parë në Tiranë. Aty me sa duket iu dha mundësia të njihet me njëkën e inteligjencës së kryeqytetit, pasi atëhere ata ishin të inkuadruar, për të kryer atë që quhej zbor ushtarak, në njësinë që ai komandoonte. E vërteta është se miqtë më të mirë ai i ka qysh kur ishte nxënës në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Ndaj nuk ka pse të çuditet askush, kur e sheh atë prej shumë e shumë vitesh, në miqësinë e profesorëve dhe sportistëve të nderuar, Ali Kastri, Ismet Belloua, Petrit Murzaku, Muhamet Përmeti, Sulejman Maliqati, Ahmet Golemi, Mikel Jankun etj. etj. futbollistë, volejbollistë, basketbollistë, boksierë, mundësa, shtangistë, gjimnastë e kështu me radhë.

Miqësinë ai e ruan të paprekur me shumë e shumë kuadro të rëndësishme të ushtrisë, me gjeneralët e dikursuem si Heroi i Popullit Rrahman Parllaku etj., por edhe me oficerët e thjeshtë. Atë, kudo që të vejë, do të shohësh se po kaq shumë e duan dhe e respektojnë edhe ushtarët që kanë kryer shërbimin ushtarak, në repartet që vareshin prej tij.

Zemërmadh, tolerant, i ndershëm, kurajoz dhe mbi të gjitha duke dhënë shembullin e tij, ai zotëronë si pak kush artin e të fituarit të zemrave.

Shërbimi në armën e zbulimit, i dha mundësinë që të shkonte deri në Vietnamin e largët, për të ndjekur nga afër luftimet që zhvilloheshin atje, mes vietnamezëve dhe amerikanëve. Ishte i preferuari i më të shquarit gjeneral të ushtrisë shqiptare, Petrit Dumes, shef i shtatmadhorisë për një periudhë të gjatë. Asgjësimin e asaj që u quajt padrejtësisht "kastë puçiste", ai e përjetoi me shumë dhembje. Aty iu lëndua besimi në pagabueshmërinë e udhëheqjes dhe i pa me sy kritik të gjitha veprimet që u ndërmoren në emër të forcimit të ushtrisë.

Në shumë e shumë mënyra, ai e manifestonte urrejtjen për kontrollin e ushtarëve, duke i quajtur ato gesharake, dhënien e llogarisë së kuadrove para masës, vënie e partisë mbi komandën, formalizimin e komisarëve që më shumë interesoheshin për stendat e kuqe sesa për stërvitjen dhe sido-

mos llafazanërinë e tyre të pabereqet. Në shumë forma tregonte antipatinë e tij për mbledhjet e organizatës bazë që më shumë sipas tij, merrej me thash e theme, sesa me punë konkrete.

Natyrishit që me këtë qëndrim ai nuk kish sesi t'i shpëtonte syrit "vijilient" të Partisë dhe sidomos të sigurimit famëkeq. Pas plenumit të pestë, nisi përndjekja ndaj tij, me akuzat absurde, duke e quajtur deri imitues të Napoleon Bonapartit, ngaqë mbante veshur përherë çizmet. Më pas kur P. Dumja u godit, atë dëshë ta ngatëronin me të duke e pyetur si provokatorë të liq, se çfarë i kishte thënë ai, para se të pushkatohej.

Dashuria e madhe e vartësve dhe mbrojtja që dikush atje lart i bëri, e shpëtuan nga ndëshkimi këtë njeri dhe kuadro të mrekullueshëm.

Kur nisën proceset demokratike, ai ka qenë ndër të parët kuadro drejtues në ushtri që i mbështetën me guxim ato. Novruz Zejnati, duke e parë situatën si intelektual, dajti të orientohet drejtë dhe të ndikonte tek të tjerët në këtë drejtim.

Me reformën në ushtri, ai në vitin 1994, u nxorr në lirim edhe pse mund të jepte për ushtrinë si askush. Ai u merrzot, por e kuptonte se reforma duhej bërë me çdo çmim. Mendja dhe zemra e tij ditë e natë aty punonin; tek ushtria e tij e dashur ku ai ishte rreshtuar qysh fëmijë. Në këto kushte, vendosi që ende t'i shërbente asaj, duke shkruar për përvojën dhe eksperiencën e tij. Ndaj nuk i ndërpreu studimet në fushën e historisë ushtarake dhe shkruan e shkruan pa pushim. Librat e parë ia kushton asaj që përjetoi në Vietnam. Ishte një luftë me pasojë të mëdha dhe gati gati e pa parë. Deri tani ajo njëhjet tek ne ashtu siç na e kishte paraqitur propaganda komuniste. Novruzi na dha të vërteta ushtarake dhe njerëzore kretë të pa njohura më parë. Ai analizozi shkaqet që çuan në atë luftë dhe mësimet që dalin prej saj. Librat e tij, duke qenë të shkruara thjeshtë dhe qartë, lexohen me ëndje. Ato dallohen për anë e tyre artistike. Dhe këtu ka ndikuar dhe fakti se ai ka kulturë letrare, gjë që është forcuar edhe nga kryerja e fakultetit të Gjuhë - letërsisë në Universitetin e Tiranës.

Interesat e këtij krijuesi sa vinë e rriten. Tani ai guxon të ndërmarë shkrimin dhe botimin e librave monografikë për figura që kanë ngjallur diskutime, për hir të personalitetit, veprimeve të



tyre dhe të kohës kur jetuan dhe u gjykuan, si ajo e mbretit të shqiptarëve Ahmet Zogu dhe Esat Pashës.

Si gjithmonë, Novruz Zejnati, nuk i trembet debatit shkencor. Ai është gati të polemizojë me historianë, me shkrimtarë dhe lexues të letërsisë e historisë. Kur e sheh se dikush ka të drejtë, ai nuk e ka të vështirë të pranojë vrejttet e bëra.

Herë pas here, si për t'u çlodhur, ai shkruan e boton libra me karakter thjesht letrar si "Bukuria e fjalës" etj.

Nga puna e madhe që bën duke studiuar apo shkruar deri në orët e vona të natës, atë e ngre vetëm kërkesa e ndonjë shoku për të pirë një kafe, apo për ta çuar diku ku njëri apo tjetri ka nevojë për makinën e tij që tani të gjithë e quajnë "mësimore".

Nga puna shkëputet gjithashtu sa herë i vinë shokë e miq të vjetër, të cilët i pret e përçjell me shumë bujari.

I gatshëm dhe gati duke fluturuar tregohet ai veçanërisht me të njohurit e kohës kur ishte skënderbegas, qofshin ata mësues, komandantë a shokë të shkollës.

Ai mbeti një nga djemtë që e nderuan më shumë atë shkollë të lavdishme, e cila përgatiti sa e sa ushtarakë të aftë dhe intelektualë të shquar si ai.

Novruz Zejnati edhe pse është në pension, në asgjë nuk të kujton kolonelin e G. G. Markestit që nuk kishte se kush t'i shkruante. Ai ka shokë e miq ngado dhe shkruan e shkruan për të gjithë.